

Ligj për arsimin fillor

Ligj për arsimin fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014 dhe 135/2014).

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet arsimi i obligueshëm fillor, që realizohet në shkollat fillore (në tekstin e mëtejme: shkolla fillore), si dhe veprimtaria e arsimit fillor, si pjesë e sistemit unik edukativ arsimor.

Neni 2

(1) Secili fëmijë ka të drejtë për arsim fillor.

(2) Ndalohet diskriminimi në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë nacionale, sociale, politike, fetare, pronësore dhe shoqërore në realizimin e të drejtave nga edukimi dhe arsimi fillor, të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 3

Qëllimet e edukimit dhe arsimit fillor janë:

- arritja e diturive të përgjithshme dhe aplikative, që janë të nevojshme në jetën e përditshme ose për arsimin e mëtejme,
- zhvillimi harmonik, intelektual, emocional dhe social i nxënësve në përputhje me aftësitë e tyre,
- zhvillimi i shkrim-leximit dhe aftësive të nxënësve për t'u kuptuar, informuar dhe shprehur në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik,
- zhvillimi i shkrim-leximit dhe aftësive të nxënësve për t'u kuptuar, informuar dhe shprehur përveç në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, edhe në gjuhën dhe alfabetin e pjesëtarëve të bashkësive që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase,
- zhvillimi i vetëbesimit dhe vetëdijes të nxënësi për individualitetin dhe përgjegjësinë personale për veprimet e veta,
- edukimi për tolerancën, bashkëpunimin e ndërsjellë, respektimin e dallimeve, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut,
- zhvillimi i vetëdijes të nxënësit për përkatësinë e Republikës së Maqedonisë dhe kultivimi i identitetit të vet nacional dhe kulturor,
- edukimi për vlerat e përgjithshme kulturore dhe civilizuese, që dalin nga traditat botërore,
- përvetësimi i diturive të përgjithshme dhe aplikative që mundësojnë veprim të pavarur kreativ në mjedisin shoqëror dhe natyror, dhe zhvillimi i aftësive për gjykim dhe të shprehurit në art dhe tradita kulturore,
- zhvillimi i aftësive për hulumtim, eksperimentim dhe zgjidhjen e problemeve,
- përfshirja dhe përkujdesja për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore,

- zhvillimi i prirjes së nxënësve në sfera të ndryshme dhe
- përparimi i mënyrës së shëndoshë të jetës dhe edukimit për marrjen e përgjegjësisë për shëndetin personal dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Neni 4

Arsimi fillor është i obligueshëm, zgjat nëntë vjet dhe organizohet në tri periudha edukative-arsimore, edhe atë nga klasa e parë deri në klasën e tretë, nga klasa e katërt deri në klasën e gjashtë dhe nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.

Neni 5

Prindi, përkatësisht tutori i nxënësit (në tekstin e mëtejme: prindi) është i obliguar t'ia mundësojë fëmijës së vet, që ta plotësojë obligimin për arsimin dhe edukimin e obligueshëm fillor.

Neni 6

Për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore sigurohen kushte përkatëse për arritjen e edukimit dhe arsimin fillor në shkollat e rregullta dhe të veçanta fillore, dhe kanë të drejtë edhe për ndihmë individuale për arritjen e edukimit dhe arsimin fillor.

Neni 7

(1) Për fëmijët e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë që qëndrojnë jashtë vendit, organizohet mësimdhënie për mësimin e gjuhës dhe kulturës maqedonase, ndërsa për pjesëtarët e bashkësive që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase edhe në gjuhën amtare, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(2) Fëmijëve të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, që kanë qëndruar jashtë vendit dhe janë kthyer në Republikën e Maqedonisë ku e fillojnë, përkatësisht e vazhdojnë arsimin fillor, shkollat fillore janë të obliguara që t'u ndihmojnë në mësimin e gjuhës amtare.

(3) Për përfshirjen e suksesshme në procesin edukativ arsimor të nxënësve nga paragrafi (2) i këtij neni, shkolla fillore ku është regjistruar nxënësi, organizon mësim plotësues individual dhe grupor për përvetësimin e gjuhës amtare dhe për kompensimin e diturisë nga lëndë të caktuara mësimore.

(4) Mësimi për nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni, realizohet sipas plan-programit mësimor, që e përpilon Byroja për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin e mëtejme: Byroja), ndërsa e konfirmon ministri kompetent i Arsimit (në tekstin e mëtejme: ministri).

(5) Mësimi për nxënësit nga paragrafi (2) i këtij neni zgjat më së shumti një vit dhe realizohet sipas programit që e përgatit Byroja, ndërsa e konfirmon ministri.

(6) Mënyrën dhe procedurën për zgjedhje të arsimtarëve të cilët e realizojnë planprogramin mësimor nga paragrafi (4) i këtij ligji, si dhe mënyrën e përcaktimit të rrogave dhe shpenzimeve të arsimtarëve, i përcakton ministri.

Neni 8

(1) Fëmijët me shtetësi të huaj apo fëmijët pa shtetësi që qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë, kanë të drejtë për arsim fillor në kushte të njëjta, si fëmijët shtetas të Republikës së Maqedonisë.

(2) Për fëmijët nga paragrafi (1) i këtij neni, organizohet mësim nga gjuha amtare, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(3) Fëmijët shtetas të shteteve anëtare të Unionit Evropian kanë të drejtë për arsim fillor, në kushte të njëjta si fëmijët shtetas të Republikës së Maqedonisë.

(4) Fëmijët shtetas të shteteve anëtare të Unionit Evropian, prindërit e të cilëve janë me qëndrim në Republikën e Maqedonisë, ku kryejnë apo kanë kryer veprimtari të pavarur, përkatësisht të cilët janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, kanë të drejtë për marrjen e diturive nga gjuha dhe kultura amtare e shtetit prej nga vijnë.

(5) Ministria është e obliguar që në bashkëpunim me themeluesin e shkollës dhe shtetin prej nga vjen nxënësi nga paragrafi (3) i këtij neni, e në pajtim me mundësitë, të japë përkrahje për marrjen e njohurive nga gjuha dhe kultura amtare e shtetit prej nga vjen nxënësi.

Neni 9

(1) Puna edukative-arsimore në shkollën fillore realizohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

(2) Për nxënësit e pjesëtarëve të bashkësive që e ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, puna edukative-arsimore realizohet në gjuhën dhe alfabetin e bashkësisë përkatëse, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

(3) Nxënësit nga paragrafi (2) i këtij neni, në mënyrë obliguese e mësojnë edhe gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

Neni 10

(1) Arsimi fillor organizohet dhe realizohet në shkollë fillore.

(2) Arsimi fillor organizohet dhe realizohet në institucione shëndetësore, institucione sociale, institucione ndëshkuese - përmirësuese dhe edukuese-përmirësuese në pajtim me këtë ligj.

(3) Arsimi fillor për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, organizohet dhe realizohet në shkolla të veçanta fillore dhe në paralele të veçanta në shkollat e rregullta fillore.

Neni 11

Në shkollën fillore ndalohet organizimi dhe veprimi politik dhe fetar, si dhe paraqitja e shenjave partiake dhe fetare.

Neni 12

(1) Veprimtaria e shkollës fillore është me interes publik.

(2) Shkolla fillore e ka statusin e personit juridik dhe regjistrohet në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

Neni 13

Shkolla fillore ka vulë. Në mesin e vulës është stema e Republikës së Maqedonisë, ndërsa anësh emri i Republikës së Maqedonisë dhe emri (titulli) dhe selia e shkollës.

Neni 14

(1) Emri i shkollës fillore është i shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

(2) Në shkollat fillore ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë dhe alfabet të ndryshme nga gjuha maqedonase, emri i shkollës shkruhet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

Neni 15

Në arsimin fillor mund të përfshihen edhe persona të moshës madhore, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 15-a

(1) Shkolla fillore grumbullon, përpunon, ruan, dërgon dhe shfrytëzon të dhëna të përmbajtura në përmbledhjet e të dhënave në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, për nevojat e bazës së integruar të të dhënave të cilën e mban Ministria.

(2) Përmbledhjet e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni mbahen për qëllimet si vijojnë:

- përparimin e proceseve dhe procedurave të nevojshme për menaxhim me resurseve njerëzore, financa dhe infrastrukturën në shkolla fillore,
- sigurimin e të dhënave me kohë, konsistente, të plota dhe të sakta që do të paraqesin mbështetje të procesit të miratimit të vendimeve, zbatimit të politikës arsimore dhe planifikimit të reformave në arsimin fillor,
- sigurimin e të dhënave të domosdoshme për funksionimin e nënsistemeve tjera (ditari elektronik dhe kontrolli ekstern i arritjeve të nxënësve) në arsimin fillor dhe
- menaxhimin efikas me ndarjen e mjeteve në sistemin arsimor të decentralizuar, planifikimin e

ndërtimit dhe rekonstrukcionin e infrastrukturës shkollore dhe avancimin profesional të të punësuarve në shkolla fillore.

Neni 15-b

Në shkollën fillore mbahen përmbledhjet e të dhënave, si vijojnë:

- 1) përmbledhja e të dhënave për nxënësit e regjistruar në shkollën fillore,
- 2) përmbledhja e të dhënave për prindërit, përkatësisht tutorët e nxënësve të regjistruar në shkollën fillore dhe
- 3) përmbledhja e të dhënave për të punësuarit në shkollën fillore.

Neni 15-v

(1) Përmbledhja e të dhënave për nxënësit e regjistruar në shkollë fillore nga neni 15-b pika 1 e këtij ligji i përfshin: NUAQ, mbiemrin, emrin e babait dhe emrin e nxënësit, datëlindjen dhe vendlindjen, gjininë, përkatësinë e bashkësisë, gjuhën amtare të nxënësit, adresën, vendbanimin, telefonin për kontakt, e-mail adresën, nevojën e posaçme arsimore, statusin e nxënësit (i rregullt/me korrespondencë).

(2) Përmbledhja e të dhënave për të dhënat e prindërve, përkatësisht tutorëve të nxënësve të regjistruar në shkollë fillore nga neni 15-b pika 2 e këtij ligji, i përfshin: farefisninë me nxënësin, emrin dhe mbiemrin, datëlindjen dhe vendlindjen, gjininë, përkatësinë e bashkësisë, adresën dhe vendbanimin, telefonin për kontakt, e-mail adresën, shkollën e arsimit.

(3) Përmbledhja e të dhënave për të punësuarit në shkollë nga neni 15-b pika 3 e këtij ligji i përfshin: NUAQ, mbiemrin, emrin e babait dhe emrin e të punësuarit, gjininë, përkatësinë e bashkësisë, datëlindjen dhe vendlindjen, adresën, vendbanimin, komunën, adresën dhe vendbanimin e përkohshëm, shtetësinë, llojin dhe shkollën e arsimit, fakultetin/shkollën e fundit të mbaruar, përvojën paraprake të punës, kategorinë e të punësuarit, vendin e punës me fondin e orëve, telefonin për kontakt, numrin e telefonit zyrtar, e-mail adresën, llojin e transportit deri te vendi i punës të cilin e shfrytëzon i punësuarit, invaliditetin, njësinë rajonale të FSSH-së, numrin e SPIM, datën e punësimit, datën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, bazën për ndërprerje të marrëdhënies së punës, statusin e të punësuarit (në kohë të pacaktuar/kohë të caktuar).

(4) Të dhënat personale nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, shkolla fillore i merr nga prindërit/tutorët e nxënësve, kurse të dhënat personale nga paragrafi (3) i këtij neni i merr nga të punësuarit në shkollë.

Neni 15-g

(1) Prindi apo i punësuarit në shkollë në rast të ndryshimit të të dhënave detyrohet ta njoftojë shkollën në afat prej shtatë ditësh nga dita e ndryshimit të shkaktuar, kurse shkolla detyrohet që në afat prej tri ditësh ta kryejë ndryshimin në përmbledhjen e të dhënave.

(2) Prindi apo i punësuar në shkollë kanë të drejtë qasjeje në të dhënat personale të përmbajtura në nenin 15-b të këtij ligji, si dhe të marrin kopje apo ta kopjojnë informatën për të dhënë personale.

(3) Prindi apo i punësuar në shkollë kanë të drejtë të kërkojnë korrigjim të të dhënës personale, me parashtrim të kërkesës me shkrim në shkollë.

(4) Shkolla detyrohet që në afat prej 30 ditësh të bëjë korrigjim dhe ta njoftojë prindin, përkatësisht të punësuarin në shkollë për korrigjimin e bërë.

Neni 15-d

(1) Drejtori i shkollës fillore, nga radhët e të punësuarve në shkollë autorizon person, përkatësisht persona për përpunim të të dhënave personale nga neni 15-v i këtij ligji.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, e kanë për obligim që të dhënat personale t'i mbajnë të fshehta. Në të dhënat personale mund të kenë qasje edhe persona tjerë profesionistë të autorizuar nga ministri, të cilëve këto të dhëna u nevojiten për realizim të kontrollit ekstern të arritjeve të nxënësve dhe ditarit elektronik, në pajtim me ligjin.

Neni 15-gj

Për qëllimet e hulumtimeve shkencore dhe përgatitjes së analizave statistikore, të dhënat personale mund të shfrytëzohen, publikohen dhe ruhen, por jo në formë e cila mundëson identifikimin e personit me të cilin kanë të bëjnë të dhënat.

Neni 15-e

(1) Përmbledhja e të dhënave për nxënësit dhe përmbledhja e të dhënave për prindërit, përkatësisht tutorët e nxënësve, që i mban shkolla fillore, ruhen një vit pas mbarimit të shkollës fillore të nxënësit, përkatësisht një vit pas çregjistrimit të tij nga shkolla fillore.

(2) Përmbledhja e të dhënave për të punësuarit që e mban shkolla fillore, ruhet deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës së të punësuarit në shkollën fillore.

Neni 15-zh

Mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personat që janë të autorizuar t'i shfrytëzojnë të dhënat e përmbajtura në përmbledhjet individuale të të dhënave personale nga neni 15-d i këtij ligji, kriteret sipas të cilave përcaktohet niveli i qasjes së personave që janë të autorizuar t'i përpunojnë të dhënat personale, masat teknike dhe organizative për sigurim të fshehtësisë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale, mënyrën e asgjësimit pas kalimit të afatit të ruajtjes së të dhënave personale dhe masat tjera, i përcakton ministri.

II. THEMELIMI DHE NDËRPRERJA E PUNËS SË SHKOLLËS FILLORE

1. THEMELIMI I SHKOLLËS FILLORE

Neni 16

- (1) Shkolla fillore mund të jetë komunale ose shtetërore.
- (2) Shkolla fillore komunale themelohet nga komuna.
- (3) Shkolla fillore shtetërore themelohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria).
- (4) Këshilli komunal merr vendim për themelimin e shkollës fillore, pas mendimit pozitiv të marrë paraprakisht nga Qeveria.
- (5) Shkollat fillore shtetërore që i themelon Qeveria, themelohen për realizimin e plan-programeve mësimore për arsimin fillor të nxënësve të caktuar, për të cilët shteti ka interes të veçantë (shkolla për nxënës me nevoja të veçanta arsimore).
- (6) Komuna, përkatësisht Qeveria mund të themelojë edhe shkollë publike ndërkombëtare në të cilën realizohet plan dhe programe mësimore në ndonjë prej gjuhëve të huaja botërore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), që me propozim të Byrosë, i përcakton ministri.

Neni 17

- (1) Shkolla fillore mund të themelohet, nëse:
 - ka numër të mjaftueshëm të nxënësve për formimin e së paku nga dy paraleleve nga klasa e parë deri në klasën e nëntë,
 - është siguruar kuadri përkatës arsimor,
 - janë siguruar lokale përkatëse shkollore, pajisja dhe mjetet mësimore në pajtim me normativat dhe standardet e përcaktuara dhe
 - janë siguruar mjetet e nevojshme financiare.
- (2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, shkolla fillore mund të themelohet edhe kur nuk ka numër të mjaftueshëm të nxënësve për formimin e tetëmbëdhjetë paraleleve, nëse themeluesi siguron mjete të mjaftueshme financiare për punë.
- (3) Normativat dhe standardet nga paragrafi (1) alineja (3) e këtij neni i përcakton ministri me propozimin e Byrosë.

Neni 18

Themeluesi është i obliguar që gjatë themelimit të shkollës fillore të formojë komision, i cili në pajtim me këtë ligj i kryen përgatitjet për fillimin e shkollës me punë.

Neni 19

(1) Me aktin për themelimin e shkollës fillore, përcaktohet:

- emri dhe selia e shkollës fillore,
- numri i nxënësve,
- rajoni, përkatësisht rajonet prej nga përfshihen nxënësit,
- gjuha në të cilën do të zhvillohet mësimi,
- numri i shkollave rajonale,
- kuadri i nevojshëm mësimor, pajisja, lokali sipas standardëve dhe normativave,
- programi për veprimtarinë edukative-arsimore,
- mjetet që themeluesi i ka siguruar për themelimin dhe fillimin e punës së shkollës fillore dhe mënyrën e sigurimit të mjeteve dhe
- fillimi i punës së shkollës fillore.

(2) Shkolla fillore mund të fillojë punën pasi që Ministria kompetente për Arsim (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) do të konfirmojë se janë plotësuar kushtet nga neni 17 i këtij ligji, dhe do të miratojë aktvendim për verifikim.

(3) Kontrollin e përmbushjes së kushteve për verifikim e kryen komisioni i formuar nga ministri.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni mund t'i paraqitet ankesë Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë nga sfera e arsimit.

(5) Mënyrën e verifikimit të shkollës fillore e përcakton ministri.

Neni 20

(1) Shkolla fillore në përbërjen e vet mund të ketë shkollë rajonale.

(2) Shkolla rajonale organizohet në vendbanim me numër të vogël nxënësish, për çka vendos themeluesi pas mendimit paraprak pozitiv nga ministri.

2. STATUTI I SHKOLLËS FILLORE

Neni 21

(1) Shkolla fillore ka statut.

(2) Me statut veçanërisht rregullohet: organizimi dhe kryerja e veprimtarisë edukative-arsimore, emri, selia, menaxhimi dhe udhëheqja, të drejtat dhe obligimet e nxënësve, të drejtat dhe obligimet e të punësuarve dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shkollës fillore.

(3) Statutin e shkollës fillore e miraton këshilli i shkollës.

(4) Për statutin e shkollës fillore pëlqim jep Ministria.

3. REGJISTRI

Neni 22

- (1) Ministria e mban regjistrin qendror të shkollave fillore, të themeluara në territorin e Republikës së Maqedonisë.
- (2) Secila komunë për rajonin e vet mban regjistër të shkollave fillore, dhe për këtë i dërgon të dhëna Ministrisë.
- (3) Formën dhe përmbajtjen si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i përcakton ministri.

3. NDËRPRERJA E PUNËS SË SHKOLLËS FILLORE 3

Neni 23

- (1) Shkolla fillore e ndërpret punën nëse nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji, dhe aktet nënligjore që dalin prej tij.
- (2) Procedurën për ndërprerjen e punës së shkollës fillore e ngre dhe e udhëheq themeluesi, pas pëlqimit paraprakisht të Ministrisë.
- (3) Procedurën për ndërprerjen e punës së shkollës fillore rajonale e ngre dhe e udhëheq themeluesi, pas pëlqimit paraprakisht të Ministrisë.

Neni 24

- (1) Themeluesi i shkollës fillore miraton akt për ndërprerjen e punës, nëse shkolla fillore:
 - nuk i realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit dhe
 - ka pushuar që t'i përmbushë kushtet e përcaktuara me këtë ligj.
- (2) Pas miratimit të aktit për ndërprerjen e punës së shkollës fillore, themeluesi është i obliguar që nxënësve t'u sigurojë ta vazhdojnë arsimimin, në llogari të themeluesit.
- (3) Shkolla fillore pas miratimit aktit për ndërprerjen e punës fshihet nga regjistrat nga neni 22 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.
- (4) Akti për ndërprerjen e punës së shkollës fillore botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në fletën zyrtare të komunës.
- (5) Themeluesi në afat prej tri ditësh nga miratimi i aktit për ndërprerjen e punës së shkollës fillore, e njofton Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë për shlyerje nga regjistri.

III. PROGRAMET DHE ORGANIZIMI I PUNËS EDUKATIVE ARSIMORE NË SHKOLLËN FILLORE

1. PLAN-PROGRAMET MËSIMORE

Neni 25

- (1) Ministri e përcakton Konceptin për edukimin dhe arsimin fillor, në bazë të të cilit miratohen plan-programet mësimore për arsimin fillor (në tekstin e mëtejshëm: planprogramet mësimore).
- (2) Në shkollën fillore, puna edukative-arsimore organizohet dhe realizohet sipas plan-programeve mësimore, të cilat me propozimin e Byrosë i verifikon ministri.
- (3) Plani mësimor i shkollës fillore përmban lëndë obliguese dhe zgjedhore, mësim plotësues dhe mësim shtesë, si dhe orë për bashkësinë e klasës.
- (4) Me planin mësimor përcaktohet numri vjetor dhe javor i orëve për mësimin veç e veç për lëndët obliguese dhe zgjedhore, orarin e tyre nëpër klasë, numrin e orëve javore për mësimin plotësues, orët për mësimin shtesë dhe orën për bashkësinë e klasës.
- (5) Me programet mësimore përcaktohen qëllimet mësimore, përmbajtjet, nocionet themelore, aktivitetet dhe metodat në mësim, notimi i arritjeve të nxënësve, kushtet për realizimin e programit mësimor dhe normativi i kuadrit mësimor.
- (6) Me programet mësimore përcaktohet shfrytëzimi i obligueshëm i teknologjive informatike - komunikuese në shkollë për realizimin e punës edukativo - arsimore.

Neni 25-a

- (1) Në shkollë fillore mund të realizohet edhe program ndërkombëtar për arsim fillor për çfarë pëlqim jep ministri.
- (2) Mjetet për realizimin e programit ndërkombëtar për arsim fillor i siguron Ministria. Mënyrën e sigurimit të mjeteve e përcakton ministri.
- (3) Programi ndërkombëtar për arsim fillor është me vlefshmëri të njëjtë, si arsimi fillor i rregullt.

Neni 26 [4](#)

Ministria për çdo nxënës në arsimin fillor siguron një libër (lektyrë) bashkë me CD në gjuhën angleze, që nxënësit të fitojnë njohuri më të madhe në gjuhën angleze, përmes leximit dhe dëgjimit të njëkohshëm të shqiptimit në gjuhën natyrore, amtare angleze.

Neni 27

(1) Mësim plotësues organizohet për nxënës të cilët në vazhdimësi tregojnë rezultate të dobëta në mësim, e veçanërisht nëse:

- kanë së paku dy nota të dobëta,
- kanë rezultate të dobëta në lëndë të caktuar mësimore,
- mungojnë nga mësimi në lëndë të caktuar mësimore dhe
- me kërkesë të nxënësit ose prindit, përkatësisht tutorit të tij.

(2) Arsimitari i cili e realizon mësimin në lëndë mësimore, i detyron nxënësit nga paragrafit (1) alineja 1 të këtij neni, për ndjekje të mësimit plotësues, ndërsa për nxënësit nga paragrafit (1) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni, mësim plotësues organizohet me vlerësim të arsimtarit.

(3) Nxënësi i dërguar në mësim plotësues, gjatë një muaji ndjek mësim plotësues më së shumti në dy lëndë mësimore me më së shumti katër orë mësimore për lëndë mësimore.

(4) Nëse nxënësi nuk i ndjek orët e mësimit plotësues merr mungesë të paarsyeshme.

(5) Për dërgimin e nxënësit në mësim plotësues arsimtari detyrimisht e njofton prindin, përkatësisht tutorin.

Neni 28

(1) Mësimi shtesë organizohet për nxënës të cilët në vazhdimësi arrijnë rezultate të konsiderueshme në lëndë të caktuara mësimore (nxënës të talentuar).

(2) Mësimin shtesë për nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni, arsimtari detyrohet që t'ua ofrojë nxënësve, ndërsa nxënësit vendosin nëse do ta ndjekin mësimin shtesë.

Neni 28-a

(1) Shkolla fillore më së voni deri më 20 shtator në vitin rrjedhës mësimor duhet të paraqesë orar për mësim plotësues dhe mësim shtesë për çdo lëndë mësimore, në vend të dukshëm në shkollë dhe të njëjtin ta dorëzojë në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit.

(2) Për arsimtarin i cili pa arsye nuk do ta realizojë mësimin plotësues dhe shtesë në pajtim me orarin nga paragrafi (1) i këtij neni, do të ngritët procedurë për shkelje disiplinore.

(3) Për shkelje disiplinore nga paragrafi (2) i këtij neni, arsimtarit i shqiptohet masë disiplinore dënim me para prej 10% deri në 30% nga shuma njëmuajore e rrogës neto të paguar nëpunësit publik në muajin para kryerjes së shkeljes disiplinore, në kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj.

Neni 29

Në orën e bashkësisë klasore përpunohen përmbajtje për zhvillimin personal dhe social të nxënësve, sipas programit që e përcakton ministri me propozimin e Byrosë.

Neni 30

(1) Plan-programet mësimorë për arsimin fillor të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, në shkollat e veçanta dhe në paralelet e veçanta në shkollat fillore, i përcakton ministri me propozimin e Byrosë.

(2) Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, lëndët e obligueshme dhe zgjedhore realizohen me programet e adaptuara, sipas nevojave të tyre të veçanta arsimore.

Neni 31

Plan-programet mësimore për arsimin fillor muzikor dhe të baletit i përcakton ministri me propozimin e Byrosë.

Neni 31-a

(1) Në shkollën fillore mund të realizohen, programi eksperimental dhe projekti kërkimor-zhvillimor, për avancimin e procesit edukativo-arsimor.

(2) Programin eksperimental dhe projektin kërkimor-zhvillimor nga paragrafi (1) i këtij neni, i përpilon dhe/ose propozon Byroja, ndërsa i miraton ministri.

2. PROGRAMI I ZGJERUAR

Neni 32

(1) Në shkollën fillore realizohet edhe programi i zgjeruar, sipas Konceptit për edukimin dhe arsimin fillor.

(2) Programi i zgjeruar i shkollës fillore përfshin pranimin dhe mbrojtjen e organizuar të nxënësve një orë para fillimit të orëve për mësim të rregullt dhe një orë pas përfundimit të mësimit të rregullt, si dhe qëndrimin e vazhduar.

Neni 33

(1) Shkolla fillore për nxënësit e klasës së parë, të dytë dhe të tretë, e organizon pranimin dhe mbrojtjen e nxënësve një orë para fillimit të orëve për mësim të rregullt, dhe një orë pas përfundimit të mësimit, në pajtim me prindin.

(2) Shkolla fillore për nxënësit nga klasa e parë deri në të tretën, mund të organizojë qëndrim të vazhduar për nxënësit nga paralelja e njëjtë, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria. Në qëndrimin e vazhduar nxënësit përfshihen në pajtim me prindin.

(3) Nëse janë siguruar kushte dhe mjete nga themeluesi, shkolla fillore mund të organizojë qëndrim të vazhdueshëm për nxënësit në grupe si vijon, nga klasa e parë deri në klasën e pestë me nxënës nga klasa e njëjtë, ose nga klasa e parë deri në klasën e tretë dhe nga klasa e katërt dhe e pestë me nxënës nga klasë të ndryshme. Në qëndrimin e vazhduar nxënësit përfshihen në pajtim me prindin.

(4) Në kohën e qëndrimit të vazhduar nxënësit mësojnë, i bëjnë detyrat e shtëpisë, kryejnë obligime të tjera shkollore dhe marrin pjesë në aktivitete kulturore-artistike dhe aktivitete të tjera, në pajtim me programin vjetor për punën e shkollës.

Neni 34

(1) Për zhvillimin e interesave të ndryshme të nxënësve, shkolla fillore organizon aktivitete të lira të nxënësve, të cilat caktohen me programin vjetor për punën e shkollës.

(2) Nxënësit në aktivitetet e lira të nxënësve përfshihen vullnetarisht.

(3) Për nxënësit që tregojnë sukses të veçantë për lëndë të caktuara organizohen gara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror.

(4) Garat i organizojnë shoqatat e akredituara të arsimtarëve.

(5) Shoqatat e arsimtarëve duhet të akreditohen nga komisioni për akreditim të shoqatës së arsimtarëve, i formuar nga ministri.

(6) Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët tre janë përfaqësues të Ministrisë, tre të Byrosë dhe një përfaqësues nga sindikata shumicë e arsimtarëve. Një anëtar i komisionit është kryetar, të cilin e emëron ministri.

(7) Kriteret themelore për akreditim të shoqatave të arsimtarëve për organizim të garave janë: garat e nxënësve të organizohen nga arsimtarët të cilët realizojnë mësim për lëndë të caktuar mësimore (lëndë të ngjashme ose sferë shkencore të cilës i takon lënda mësimore), shoqatat e arsimtarëve të jenë të regjistruara si shoqatë së paku tre vjet deri në ditën kur aplikojnë për organizim të garave dhe të sigurojnë organizim të garave në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë në të gjitha gjuhët mësimore.

(8) Për vendin e parë të fituar në gara në nivel shtetëror, nxënësit dhe arsimtarit të tij u ndahet shpërblim me para, lartësinë e të cilit e përcakton ministri, me propozim të komisionit nga paragrafi (6) i këtij neni.

(9) Lartësia e shpërblimit me para nga paragrafi (8) i këtij neni është në shumë më së shumti deri 50% nga neto rroga mesatare e paguar për të punësuar në Republikë në muajin e fundit para ndarjes së shpërblimit.

(10) Mënyrën dhe kriteret më të përafërta të organizimit dhe realizimit të garave të nxënësve për lëndë të caktuara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(11) Mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Neni 34-a

Për zhvillimin dhe avancimin e të gjitha formave të aktiviteteve sportive të nxënësve, së paku pesë mësimdhënës që kanë themeluar marrëdhënie pune në kohë shkollor, në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe Ligjin për sport.

Me klubin sportiv shkollor udhëheqin anëtarët drejtpërdrejtë.

Klubet sportive shkollore mjetet për financim i marrin nga kontribute vullnetare, donacione, dhurata (në para, të mira, të drejta pronësore), testamente dhe legate.

Klubi sportiv shkollor mund të marrë mjete nga buxheti i komunave, përkatësisht komunave në qytetin e Shkupit.

3. PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E SHKOLLËS FILLORE

Neni 35

(1) Programi vjetor për punën e shkollës fillore (në tekstin e mëtejshëm: programi vjetor i punës), përpilohet në bazë të programit për zhvillimin e shkollës.

(2) Me programin vjetor të punës planifikohet mësimi sipas planit mësimor dhe punës tjetër edukative-arsimore në shkollë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e programit vjetor të punës, i përcakton ministri.

(4) Këshilli i shkollës ia dorëzon programin vjetor të punës themeluesit, më së voni deri më 31 gusht në vitin rrjedhës shkollor.

(5) Programin vjetor të punës e miraton themeluesi, deri më 30 shtator për secilin vit rrjedhës shkollor.

(6) Nëse programin vjetor të punës themeluesi nuk e miraton në afatin e përcaktuar në paragrafin (5) të këtij neni, konsiderohet se i njëjti është miratuar.

(7) Programin e miratuar vjetor të punës themeluesi i shkollës ia dorëzon Byrosë dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit në formë elektronike.

Neni 36

Shkolla fillore është e obliguar që t'i njoftojë nxënësit dhe prindërit përmes broshurës me pjesë të veçanta nga programi i punës, të drejtat dhe obligimet e nxënësve dhe organizimi i punës në shkollë.

4. ORGANIZIMI I MËSIMIT NË SHKOLLËN FILLORE

Neni 37

(1) Plan-programet mësimore në shkollën fillore përpilohen sipas tri periudhave edukative-arsimore (në tekstin e mëtejme: periudha) si vijojnë:

- nga klasa e parë deri në klasën e tretë,
- nga klasa e katërt deri në klasën e gjashtë dhe
- nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.

(2) Me programet e adaptuara ose të veçanta për edukimin dhe arsimin fillor të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e veçanta dhe në paralelet e veçanta në shkollat fillore, periudhat mund të përcaktohen edhe ndryshe nga ato të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 38

(1) Viti shkollor në shkollën fillore sipas rregullit fillon më 1 shtator dhe mbaron më 31 gusht të vitit vijues.

(2) Mësimi në vitin shkollor realizohet në 180 ditë mësimorë.

(3) Mësimi në shkollën fillore nuk realizohet në kohën e festave shtetërore dhe festave të tjera të përcaktuara me ligj.

(4) Me përjashtim, mësimi mund të organizohet edhe në ditë jo pune, që të realizohen ditët mësimore nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Mësimi mund të realizohet edhe me afat të shkurtuar, por jo më pak se 100 ditë mësimore, pas pëlqimit të marrë nga Ministria, sipas programit të veçantë mësimor, të miratuar nga ministri me propozimin e Byrosë.

(6) Puna edukative-mësimore nuk guxon që të ndërpritet gjatë vitit mësimor, përveç rasteve të jashtëzakonshme (fatkeqësi natyrore, epidemi etj.), për këtë vendos themeluesi pas pajtimit paraprakisht nga Ministria.

(7) Në rast të ndërprerjes së punës edukative arsimore për shkak të grevës, drejtori i shkollës fillore me pëlqim paraprak nga kryetari i komunës, e për shkollat fillore shtetërore nga ministri, është i detyruar ta sigurojë realizimin e punës edukative arsimore me zëvendësimin e të punësuarve që bëjnë grevë, derisa zgjat greva.

Neni 39

(1) Ora mësimore zgjat 40 minuta.

(2) Ora mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore mund të zgjasë më pak se ora mësimore nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse kjo është e përcaktuar me planprogramet mësimore.

(3) Ora mësimore për nxënësit në shkollat fillore të muzikës, si dhe në institucione të tjera mund të zgjasë më pak se ora mësimore nga paragrafi (1) i këtij neni nëse kjo është e përcaktuar me plan-programet mësimore.

Neni 40

(1) Mësimi në vitin shkollor realizohet në dy gjysmëvjetore.

(2) Viti shkollor përcaktohet me kalendarin për organizimin dhe punën e shkollës fillore.

(3) Kalendarin nga paragrafi (2) i këtij, e miraton ministri.

Neni 41

(1) Mësimi në shkollën fillore realizohet në klasa, paralele dhe grupe mësimore me nxënësit e klasës së njëjtë.

(2) Klasa është tërësi edukative-arsimore në të cilën përpunohen programet mësimore, sipas planit mësimor për një vit shkollor. Nxënësit e klasës së njëjtë janë të sistemuar në paralele.

(3) Paralelja formohet nga nxënësit e klasës së njëjtë.

(4) Numri i nxënësve në paralele është prej 24 deri në 34.

(5) Paralelja mund të formohet edhe me më pak se 24 nxënës, pas pëlqimit të marrë nga themeluesi.

(6) Themeluesi mund të formojë paralele nga paragrafi (5) i këtij neni, pas mendimit pozitiv paraprak nga Ministria.

(7) Në shkollën fillore mund të formohet edhe paralele e kombinuar, sipas rregullit, nga nxënësit prej klasës së parë deri në klasën e tretë, me nxënës prej klasës së katërt dhe të pestë ose me nxënës prej klasës së gjashtë deri në klasën e nënte, pas mendimit të marrë nga themeluesi.

(8) Themeluesi mund të formojë paralele të kombinuara nga paragrafi (7) i këtij neni, pas mendimit pozitiv paraprak nga Ministria.

(9) Kur nuk mund të organizohet mësimi nëpër klasa në paralele për nxënësit në institucione shëndetësore, institucione sociale, institucione ndëshkuese-përmirësuese ose institucione edukuese-përmirësuese, shkolla fillore organizon punë individuale ose grupe edukative-arsimore.

(10) Numrin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në paralele e përcakton ministri.

Neni 42

(1) Puna edukative-arsimore në shkollën fillore përfshin mësimin dhe format e tjera të punës së organizuar me nxënësit.

(2) Mësimin në klasën e parë e realizon mësuesi i grupit klasor, pedagogu ose arsimtari për edukim parashkollor.

(3) Mësimin në klasën e dytë dhe të tretë e realizon mësuesi i grupit klasor ose pedagogu.

(4) Për realizimin e mësimin të gjuhës angleze nga klasa e parë deri në të tretën angazhohet arsimtari i gjuhës angleze.

(5) Mësimin në klasën e katërt e realizon mësuesi i grupit klasor ose pedagogu, përveç mësimin nga gjuha angleze dhe mësimin nga gjuha maqedonase, për nxënësit nga pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e realizojnë në gjuhën dhe alfabetin e ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(6) Mësimin në klasën e pestë vazhdon ta realizojë mësuesi i grupit klasor ose pedagogu, përveç mësimin nga gjuha angleze dhe mësimin nga gjuha maqedonase, për nxënësit nga pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e realizojnë në gjuhën dhe alfabetin e ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, ndërsa për shkencat natyrore dhe arsimin teknik përfshihen edhe arsimtarët e lëndës.

(7) Numri i orëve të mësuesit të grupit klasor për lëndët e obligueshme në klasën e pestë nuk mund të jetë më i vogël se 20 orë në javë, duke e përfshirë edhe orën e bashkësisë së klasës.

(8) Mësimin nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, e realizojnë arsimtarët lëndore.

(9) Në paralelet ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore, mund të angazhohet edhe defektologu për punë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

(10) Në qëndrimin e vazhduar për nxënësit nga klasa e parë punën edukative arsimore e realizojnë mësuesit e grupit klasor, pedagogu ose arsimtarët e edukimit parashkollor, ndërsa nga klasa e dytë deri në klasën e pestë mësuesit e grupit klasor ose pedagogu.

5. PUNA INDIVIDUALE DHE GRUPORE NË MËSIM

Neni 43

- (1) Për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë në mësim realizohen edhe përmbajtje dhe detyra sipas niveleve të ndërlikimit.
- (2) Nxënësit nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë, të cilët tregojnë rezultate të veçanta nga lëndë të caktuara mësimore, sipas rezultateve nga testet e standardizuara të përpiluara nga Byroja, mund të caktohen për përcjelljen e mësimin në grupe mësimore të formuara nga nxënësit e klasës së njëjtë të paraleleve të ndryshme për përvetësimin e përmbajtjeve më të ndërlikuara dhe atë më së shumti në vëllim prej 25% nga orët e përgjithshme të dedikuara për lëndën përkatëse.
- (3) Nxënësit nga paragrafi (2) i këtij neni orët nga pjesa tjetër e mësimin i përcjellin në paralelen amë të klasës së vet.
- (4) Organizimin e mësimin në grupe mësimore nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton ministri me propozimin e Byrosë.

Neni 44

- (1) Nxënësit në grupe mësimore nga lënda e veçantë të nenit 43 paragrafi (2) i këtij ligji në grupe mund të mbahen gjatë tërë vitit mësimor, ose të heqin dorë nga ai mësim.
- (2) Nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni mund ta përcjellin mësimin në vitin e njëjtë mësimor vetëm për lëndët për të cilat janë përcaktuar.
- (3) Në klasën e tetë apo të nëntë nxënësit mund t'i zëvendësojnë lëndët.

IV. REGJISTRIMI I NXËNËSVE

Neni 45

- (1) Fëmija me shkuarjen në shkollë e merr statusin e nxënësit.
- (2) Nxënësi e përcjell mësimin dhe merr pjesë në aktivitete të ndryshme të përcaktuara me plan-programme mësimore për arsimin dhe edukimin fillor.

Neni 46

- (1) Nxënësit në klasën e parë të shkollës fillore regjistrohen në muajin maj për vitin vijues shkollor.

(2) Gjatë regjistrimit të fëmijës në klasën e parë prindi është i detyruar që të dorëzojë vërtetim për vaksinat e marra të obligueshme për fëmijën, i lëshuar nga institucioni kompetent shëndetësor.

(3) Shkolla fillore është e obliguar t'i përfshijë nxënësit nga rajoni i vet.

(4) Shkolla fillore mund të regjistrojë nxënës nga rajoni tjetër ose nga komuna tjetër vetëm nëse ka vende të lira për regjistrim.

(5) Themeluesi e përcakton rajonin e shkollave fillore nga i cili regjistrohen nxënësit.

Neni 47

(1) Në klasën e parë të shkollës fillore prindi është i detyruar ta regjistrojë fëmijën, i cili deri në fund të vitit kalendarik i mbush gjashtë vjet.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni fëmija mund të regjistrohet në klasën e parë nëse i mbush gjashtë vjet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, me kërkesën paraprake nga prindi dhe mendimin e marrë nga pedagogu ose psikologu i shkollës.

(3) Regjistrimin e fëmijës me kërkesën e prindit institucioni shëndetësor mund ta prolongojë për një vit, nëse vërtetohet se fëmija nuk është i përgatitur për të shkuar në shkollë.

Neni 48

(1) Regjistrimin e fëmijës në shkollë e kryen komisioni, që e formon drejtori i shkollës. Komisioni përbëhet nga pedagogu ose psikologu dhe arsimtari i edukimit parashkollor, përkatësisht mësuesi i grupit klasor.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar që sipas rregullit, ta njoftojë prindin për përgatitjen e fëmijës për të shkuar në shkollë, së paku dy muaj para fillimit të mësimet.

(3) Prindi pas vendimit të komisionit ka të drejtë t'i paraqesë ankesë komisionit të formuar nga kryetari i komunës.

Neni 49

(1) Gjatë vitit shkollor nxënësit në klasën e parë me propozimin e arsimtarit që e udhëheq paralelen, pedagogut apo psikologut, në pajtim me prindin për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera mund t'i prolongohet përcjellja e mësimet për një vit.

(2) Për prolongimin e përcjelljes së mësimet nga paragrafi (1) i këtij neni vendos komisioni i përbërë nga psikologu, pedagogu, arsimtari i edukimit parashkollor ose mësuesi i grupit klasor.

(3) Komisionin nga paragrafi (2) i këtij neni e formon drejtori i shkollës fillore.

(4) Prindi pas vendimit të komisionit ka të drejtë për ankesë komisionit të formuar nga kryetari i komunës.

Neni 50

(1) Prindi ka të drejtë ta regjistrojë fëmijën në shkollën fillore në rajonin ku jeton, apo ku qëndron përherë.

(2) Prindi mund ta regjistrojë fëmijën në shkollën tjetër fillore në rajonin e njëjtë apo rajonin tjetër nëse për këtë ka pajtim nga shkolla ku regjistrohet.

(3) Lista e fëmijëve nga rajoni për regjistrim në shkollën fillore merret nga shërbimet kompetente në njësinë e vetadministrimit lokal, të cilat mbajnë evidencë për banorët e përhershëm dhe të përkohshëm.

(4) Lista nga paragrafi (3) i këtij neni përmban emrin dhe mbiemrin dhe vitin e lindjes së fëmijës.

(5) Gjatë shkollimit fëmija mund të kalojë në shkollë tjetër fillore nëse ka pëlqim nga shkolla në të cilën kalon.

(6) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk kanë të bëjnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Neni 51

(1) Prindi ka të drejtë që fëmijën me nevoja të veçanta arsimore ta regjistrojë në shkollën fillore, përveç në rastet kur nevojat e veçanta arsimore të fëmijës janë të atilla që ai duhet të përcjellë mësim në shkollën e veçantë fillore.

(2) Mënyrën dhe kushtet për regjistrimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore e përcakton ministri me propozimin e Byrosë.

Neni 52

Shkolla fillore është e obliguar që ta njoftojë inspektorin e autorizuar komunal të arsimit për fëmijët që nuk janë regjistruar, përkatësisht nxënësit që pa arsye nuk e përcjellin shkollën fillore më shumë se 30 ditë.

V. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E NXËNËSVE

Neni 53

Ndalohet keqtrajtimi trupor dhe psikik i nxënësit.

Neni 54

- (1) Nxënësi ka të drejtë ta përcjellë mësimin dhe të marrë pjesë në punën edukative-arsimore që e organizon shkolla fillore.
- (2) Nxënësi ka obligim që rregullisht ta përcjelle mësimin dhe t'i plotësojë obligimet dhe detyrat e planifikuara, që janë paraparë me plan-programe mësimore dhe programin vjetor të punës.
- (3) Nxënësi e ka për obligim kontrollimin intern dhe ekstern të përparimit dhe arritjes së suksesit, në mënyrë të përcaktuar në nenin 71 të këtij ligji.
- (4) Komisioni i Shkollës është i detyruar që në përputhje me orarin e përgjithshëm nga nenit 71 paragrafi (7) të këtij ligji, të organizojë termin plotësues për kontrollim ekstern të arritjeve të suksesit të nxënësve, të cilët për shkak të sëmundjes apo shkaqe të arsyeshme nuk kanë pasur mundësi që ta bëjnë kontrollimin ekstern.
- (5) Mënyrën e organizimit dhe zbatimit të kontrollimit ekstern të nxënësve e përcakton ministri, me propozim të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 55

Për nxënësit që tregojnë rezultate të konsiderueshme në sfera të veçanta, kryerja e obligimeve dhe mënyra e realizimit të programit të shkollës fillore, mund të adaptohet në mënyrën që e përcakton ministri, me propozimin e Byrosë.

Neni 56

Nxënësi për shkaqe shëndetësore mund të lirohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e veçanta mësimore në shkollën fillore në bazë të vërtetimit të lëshuar nga institucioni përkatës shëndetësor.

Neni 57

- (1) Për çdo mungesë të nxënësit nga mësimi prindi është i obliguar ta njoftojë udhëheqësin e paraleles për shkaqet e mungesës.
- (2) Nxënësi mund të mungojë nga mësimi nëse mungesën e tij prindi paraprakisht e lajmëron në shkollë, por jo më tepër se pesë ditë në vitin mësimor.
- (3) Drejtori i shkollës pas kërkesës me shkrim nga prindërit, për shkaqe të arsyeshme mund t'i lejojë nxënësit mungesë më të gjatë nga mësimi, por jo më shumë se 30 ditë.

Neni 58

- (1) Nxënësit që i ka mbushur 16 vjet i hiqet obligimi për arsimin e rregullt fillor me kalimin e vitit shkollor.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni me kërkesën e prindit ose të nxënësit, e me mendimin e pedagogut apo psikologut të shkollës, nxënësi që i ka mbushur 16 vjet mund ta vazhdojë arsimimin deri në mbushjen e 17 viteve.

(3) Nxënësi nga paragrafi (2) i këtij neni e mban statusin e nxënësit nëse e vazhdon shkollimin si nxënës i moshës madhore, në pajtim me ligjin.

(4) Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore që i ka mbushur 20 vjet, i hiqet obligimi për arsimin e rregullt fillor me kalimin e vitit shkollor.

Neni 59

Ndaj nxënësit që nuk i përmbush obligimet dhe i cenon rregullat e punës edukative-arsimore, zbatohen masa pedagogjike si vijojnë: qortim, vërejtje gojore, vërejtje me shkrim, zvogëlim i sjelljes, zhvendosja e nxënësit në paralele tjetër dhe zhvendosja e nxënësit në shkollën tjetër fillore.

Neni 60

(1) Nëse ka shkaqe të arsyeshme që lidhen me sjelljen e nxënësit në shkollën fillore, shkolla mund ta zhvendosë nxënësin në shkollën tjetër fillore nëse ka pajtim nga shkolla që duhet ta pranojë nxënësin.

(2) Për shkaqet e zhvendosjes së nxënësit në shkollën tjetër fillore, vendos komisioni i formuar nga drejtori i shkollës, i përbërë nga kujdestari i klasës ose udhëheqësi i paraleles, dy arsimtare dhe psikologu ose pedagogu i shkollës dhe kryetari i këshillit të prindërve.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij bashkëpunon me prindin e nxënësit.

(4) Nëse shkolla nuk mund ta sigurojë kalimin e nxënësit në shkollën tjetër, për këtë vendos komisioni i formuar nga kryetari i komunës.

Neni 61

(1) Nxënësi ka të drejtë për transport falas nëse vendbanimi është larg së paku dy kilometra nga shkolla më e afërt fillore.

(2) Nxënësit me nevoja të veçanta dhe personat për shoqërim të tyre arsimore kanë të drejtë transporti falas pa dallim nga largësia e vendbanimit të tyre deri te shkolla fillore.

(3) Mënyrën e organizimit të transportit falas të nxënësve, nxënësve me nevoja të posaçme arsimore dhe personave për shoqërim të tyre, nga vendbanimi deri në shkollën fillore, e përcakton ministri.

Neni 62

(1) Shkolla fillore në marrëveshje me prindërit të gjithë nxënësit mund të organizojë së paku një shujtë gjatë qëndrimit në shkollë. Shpenzimet e shujtës i paguan prindi.

(2) Standardet për ushqim dhe për shujtat në shkollë i përcakton Ministria në bashkëpunim me institucionin përkatës profesional.

Neni 63

(1) Nxënësit që dallohen me diturinë e tyre, ose me lloje të tjera arritjesh shkolla fillore i lëvdon apo i shpërblen.

(2) Nxënësve që arrijnë rezultate mbi mesataren në aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore, shkolla fillore me propozimin e këshillit të arsimtarëve u lëshon diploma dhe fletëlavdërime të veçanta.

(3) Formën dhe përmbajtjen e diplomave, si dhe mënyrën e lëshimit të tyre i përcakton ministri.

Neni 64

Mënyrën e realizimit të të drejtave dhe obligimeve të nxënësve, shpërblimin dhe kumtimin e masave pedagogjike për shkeljen e rregullave të shkollës dhe rendit shtëpiak, i përcakton ministri me propozimin e Byrosë.

V-a. KËSHILLIMI I PRINDËRVE

Neni 64-a

(1) Prindi, përkatësisht tutori dërgohet në këshillim, nëse:

- nxënësi gjatë vitit mësimor ka notë negative në tri ose më tepër lëndë,
- nxënësi ka më shumë se dhjetë mungesa të paarsyeshme ose 100 mungesa të arsyeshme,
- nxënësi është i padisiplinuar,
- nxënësi e ofendon arsimtarin,
- nxënësi merr pjesë në rrahje ose forma tjera të dhunës,
- nxënësi tregon sjellje asociale ose antisociale,
- nxënësi sillet në mënyrë të pamoralshme ose jo etike dhe
- në periudhë të shkurtër nxënësit në mënyrë të konsiderueshme i bie suksesi.

(2) Udhëheqësi i klasës, përkatësisht udhëheqësi i paraleles e fton në këshillim së paku një prind, përkatësisht tutor nga paragrafi (1) i këtij neni, me ftesë të dërguar nëpërmjet telefonit, postës ose me dorëzim personal.

(3) Nëse ftesa ka të bëjë me sjellje asociale ose antisociale të nxënësit, përkatësisht me sjellje të pamoralshme dhe joetike të nxënësit, para se të dërgohet ftesa kërkohet mendim profesional nga Shërbimi Pedagogjik.

- (4) Shërbimi Pedagogjik, në afat prej dhjetë ditësh nga pranimi i kërkesës, dorëzon mendim profesional për sjelljen e nxënësit nga paragrafi (3) i këtij neni.
- (5) Ftesa për këshillim të prindit, përkatësisht tutorit duhet të jetë me numra dhe të dorëzohet së paku tetë ditë para mbajtjes së këshillimit.
- (6) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për këshillim e përcakton ministri.
- (7) Nëse prindi, përkatësisht tutori për shkaqe të arsyeshme nuk mund t'i përgjigjet ftesës, detyrohet që për mungesën ta njoftojë udhëheqësin e klasës, përkatësisht udhëheqësin e paraleles, para mbajtjes së këshillimit ose në afat prej tri ditësh pas këshillimit.
- (8) Udhëheqësi i klasës, përkatësisht udhëheqësi i paraleles e njofton psikologun, përkatësisht pedagogun e shkollës për ftesën e dorëzuar për këshillim të prindit.
- (9) Psikologu, përkatësisht pedagogu i shkollës përpilon plan javor dhe mujor për mbajtjen e këshillimit në pajtim me bazat nga paragrafi (1) i këtij neni.
- (10) Me nxënësit prindërit përkatësisht kujdestarët e të cilëve janë dërguar për këshillim për shkak të veprimeve të nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni, psikologu, përkatësisht pedagogu realizon këshillim të nxënësit, pas përfundimit të këshillimit të prindërve, përkatësisht kujdestarëve, në pajtim me Programin për këshillim të nxënësve, të cilin me propozim të Shërbimit Pedagogjik e miraton ministri.

Neni 64-b

- (1) Këshillimin nga neni 64-a i këtij ligji, e kryen psikologu i shkollës.
- (2) Nëse në shkollë nuk ka të punësuar psikolog, atëherë këshillimin e kryen pedagogu.
- (3) Nëse në shkollë nuk ka të punësuar psikolog, përkatësisht pedagog, atëherë për këshillimin caktohet pedagog ose psikolog nga ndonjë shkollë tjetër fillore.
- (4) Psikologun ose pedagogun nga paragrafi (3) i këtij neni për shkollat fillore të komunave e cakton komuna, përkatësisht Qyteti i Shkupit, ndërsa për shkollat fillore shtetërore e cakton ministri, nga radhët e pedagogëve, përkatësisht psikologëve të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit.
- (5) Këshillimi kryhet në grupe në pajtim me planin javor dhe mujor nga paragrafi (9) i „64-a“ të këtij ligji.
- (6) Numri i prindërve në grupe nuk mund të jetë më i madh se 20.
- (7) Këshillimi realizohet në dy termine në kohëzgjatje prej 60 minutash.

(8) Në këshillimin e prindit, përkatësisht tutorit, pedagogu, përkatësisht psikologu detyrohet që të veprojë në pajtim me Programin për këshillim të prindërve, të cilin me propozim të Shërbimit Pedagogjik e miraton ministri.

(9) Psikologu, përkatësisht pedagogu gjatë këshillimit të prindërve nuk guxon ta keqpërdorë funksionin e vet.

Neni 64-v

(1) Për këshillimin e mbajtur të prindit, përkatësisht tutorit, psikologu, përkatësisht pedagogu mban procesverbal me listë të pranisë.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për këshillim e përcakton ministri.

Neni 64-g

Nëse prindi, përkatësisht tutori më shumë se katër herë në çfarëdo bazë nga neni 64-a paragrafi (1) i këtij ligji, ftohet në këshillim, në çdo këshillim të ardhshëm është i pranishëm edhe përfaqësuesi nga Shërbimi Pedagogjik.

Neni 64-d

Nëse prindi, përkatësisht tutori nuk paraqitet në këshillim edhe pas ftesës së tretë, njoftohet Qendra për Punë Sociale.

Neni 64-gj

Shërbimi Pedagogjik, për prindërit të cilët nuk i janë përgjigjur ftesës për këshillim dhe që nuk e kanë arsyetuar mungesën e tyre, parashtron propozim për ngritjen e procedurës të Inspektorati Shtetëror i Arsimit për kundërvajtje.

VI. VLERËSIMI I ARRITJEVE DHE PËRPARIMIT TË NXËNËSVE

Neni 65

(1) Arritjet e nxënësve në shkollën fillore vlerësohen në mënyrë përshkruese dhe me numra.

(2) Në periudhën e parë arritja e nxënësit gjatë vitit mësimor për lëndët e obligueshme dhe zgjedhore, vlerësohet në mënyrë përshkruese.

(3) Nxënësi nga paragrafi (2) i këtij neni vetëm në fund të vitit shkollor merr dëftesë me nota përshkruese.

(4) Në periudhën e dytë arritja e nxënësit gjatë vitit mësimor për lëndët e obligueshme dhe zgjedhore vlerësohet në mënyrë përshkruese dhe me numra.

(5) Nxënësi nga paragrafi (4) i këtij neni në gjysmëvjetorin e parë merr njoftim për suksesin me nota me numra, ndërsa në fund të vitit shkollor merr dëftesë me nota numra dhe notë për suksesin e përgjithshëm.

(6) Në periudhën e tretë arritja e nxënësit gjatë vitit mësimor për lëndët e obligueshme dhe zgjedhore, notohet me numra.

(7) Nxënësi nga paragrafi (6) i këtij neni në fund të gjysmëvjetorit të parë merr njoftim për suksesin me nota me numra, ndërsa në fund të vitit shkollor merr dëftesë me nota me numra dhe notë për suksesin e përgjithshëm.

(8) Suksesi i përgjithshëm i nxënësit përcaktohet në bazë të notave vjetore nga të gjitha lëndët sipas planit arsimor në fund të vitit dhe notat e kontrollit ekstern të arritjeve të suksesit të nxënësit, kurse për nxënësit e dërguar në provimin përmirësues pas mbarimit të provimeve përmirësuese.

(9) Notat me numra janë: shkëlqyeshëm (5); shumë mirë (4); mirë (3); mjaftueshëm (2) dhe pamjaftueshëm (1). Të gjitha notat janë të kalueshme përveç notës pamjaftueshëm (1).

(10) Nota më e lartë është shkëlqyeshëm (5).

Neni 66

Vlerësimi i nxënësit bëhet sipas standardeve që i përcakton ministri, me propozimin e Byrosë.

Neni 67

Mësuesi i grupit klasor, përkatësisht udhëheqësi i paraleles është i obliguar që ta njoftojë prindin për suksesin e nxënësit, së paku dy herë në çdo gjysmëvjetor.

Neni 68

(1) Në periudhën e parë dituria e nxënësit që e përcjell mësimin në shkollat e veçanta fillore, vlerësohet në mënyrë përshkruese.

(2) Në periudhën e dytë dhe të tretë, dituria e nxënësit që e përcjell mësimin në shkollat e veçanta fillore mund të vlerësohet në mënyrë përshkruese dhe me numra, varësisht nga lloji i pengesës së nxënësit.

Neni 69

(1) Nxënësi nga klasa e parë duke përmbyllur me klasën e pestë, sipas rregullit nuk mund ta përsëritë klasën.

(2) Nxënësi që nuk ka mundur t'i përvetësojë përmbajtjet mësimore deri në fund të vitit shkollor, si pasojë e mungesës më të gjatë nga mësimi për shkak të sëmundjes, shpërnguljes ose shkaqe

tjera të arsyeshme, me propozimin e prindit ose me propozimin e mësuesit të grupit klasor dhe të bashkëpunëtorëve të tjerë profesionalë të shkollës, e në pajtim me prindin mund të mbetet në klasën e njëjtë, e për këtë merr vendim këshilli i arsimtarëve i shkollës.

Neni 70

- (1) Nxënësi i cili në fund të vitit mësimor në klasën e gjashtë, e shtatë, të tetë apo të nëntë ka notë negative deri në dy lëndë, dërgohet në riprovim.
- (2) Për nxënësin nga klasa e gjashtë, shtatë, të tetë dhe të nëntë, i cili në fundin e vitit mësimor ka deri në dy nota negative, shkolla fillore është e obliguar që të organizojë mësim plotësues në muajin qershor.
- (3) Nxënësi nga paragrafi (2) i këtij neni, i cili pas mbajtjes së mësimit plotësuese nuk ka arritur sukses pozitiv, dërgohet në riprovim.
- (4) Riprovimeve nxënësi u nënshtrohet në muajin qershor dhe gusht.
- (5) Nxënësi nga paragrafi (3) i këtij neni, i cili nuk do ta kalojë riprovimin nga njëra apo të dyja lëndët, mbetet në klasën e njëjtë.
- (6) Nxënësi i cili në fund të vitit mësimor në klasën e shtatë, të tetë apo të nëntë ka më tepër se dy nota negative mbetet në klasën e njëjtë.

Neni 71

- (1) Ndjekja dhe kontrolli i përparimit dhe arritjes së suksesit të nxënësve kryhet me kontroll intern dhe ekstern.
- (2) Kontrollin intern të arritjes së suksesit të nxënësve e kryejnë mësimdhënësit në shkollë.
- (3) Kontrolli ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë realizohet në fund të çdo viti mësimor.
- (4) Kontrollin ekstern të arritjeve të suksesit të nxënësve e organizon dhe realizon shkolla përmes komisionit shkollor.
- (5) Komisionin shkollor për kontroll ekstern të arritjeve të nxënësve e formon drejtori i shkollës dhe i njëjti përbëhet nga pesë anëtarë: drejtori, bashkëpunëtori profesional dhe tre mësimdhënës nga shkolla.
- (6) Testimin për kontroll ekstern të arritjeve të nxënësve e realizojnë testues të caktuar nga komisioni shkollor.
- (7) Komisioni shkollor është i detyruar që për çdo hapësirë të provimit të caktojë së paku nga një testues.

(8) Në hapësirën e provimit gjatë kontrollit ekstern të arritjeve të nxënësve nuk guxojnë të hyjnë mësimdhënës që nuk janë testues ose ndihmës të testuese.

(9) Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në arsim të rregullt komisioni shkollor detyrimisht cakton person - ndihmës të testuesit.

(10) Testuesi dhe ndihmësi i testuesit nuk guxojnë të japin çfarëdo qoftë informate në lidhje me përgjigjet e pyetjeve gjatë kontrollit ekstern të arritjeve të nxënësve.

(11) Testuesi dhe ndihmësi i testuesit mund të jenë mësimdhënës të cilësdo lënde mësimore, përveç lëndës për të cilën kryhet kontrolli ekstern i arritjes së nxënësve.

(12) Mënyrën e formimit dhe punës së komisionit shkollor, sekretin e materialit për kontroll ekstern, mënyrën e kontrollit të testeve nga komisioni shkollor, si dhe formën dhe përmbajtjen e raportit, i përcakton ministri me propozim të Qendrës Shtetërore të Provimit.

(13) Kontrolli ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve kryhet me teste që i përgatit Qendra Shtetërore e Provimit, me propozim të Byrosë.

(14) Kontrolli ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve kryhet për dy lëndë mësimore në pajtim me planin mësimor, e në bazë të programit të përgjithshëm të përgatitur nga ana e Qendrës Shtetërore të Provimit me propozim të Byrosë, përveç për lëndët mësimore me të cilat nxënësit fitojnë shkathtësi, përkatësisht për lëndët mësimore për të cilat nuk mund të kryhet kontrolli ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve.

(15) Mënyrën dhe procedurën për kontroll të objektivizmit të mësimdhënësit gjatë vlerësimit të arritjeve të suksesit të nxënësve për lëndët mësimore me të cilat nxënësit fitojnë shkathtësi, përkatësisht për lëndët mësimore për të cilat nuk mund të kryhet kontrolli ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(16) Në bazë të programit të përgjithshëm nga paragrafi (14) të këtij neni, komisioni shkollor përgatit program intern për paralele, lëndë mësimore dhe mësimdhënës për realizimin e kontrollit ekstern në shkollë. Programin intern e miraton këshilli i mësimdhënësve të shkollës.

(17) Rezultatet nga kontrolli ekstern i arritjes së suksesit të nxënësve nga paragrafi (14) i këtij neni, shkolla i shënon në dëftesë për vitin e përfunduar të arsimit dhe të njëjtat ndikojnë në suksesin e përgjithshëm të nxënësit.

(18) Nxënësit që nuk është paraqitur në kontroll ekstern të arritjes së suksesit dhe të njëjtën nuk e ka arsyetuar me shkresë mjekësore, përkatësisht me vërtetim/dëshmi për pjesëmarrje në garë shtetërore apo ndërkombëtare, i shënohet nota pamjaftueshëm (1) në dëftesë, që ndikon në suksesin e përgjithshëm të nxënësit.

(19) Nxënësit i lëshohet dëftesë për vitin e mbaruar të arsimit pas kontrollit të realizuar ekstern.

(20) Rezultatet e regjistruara në dëftesë nga paragrafi (17) të këtij neni janë një nga kriteret për regjistrim të nxënësve në arsimin e mesëm.

(21) Komisioni shkollor dorëzon raport për kontrollin e realizuar ekstern të arritjeve të nxënësve në Qendrën Shtetërore të Provimit.

(22) Në bazë të raporteve të marra nga komisionet shkollore, Qendra Shtetërore e Provimit përgatit raport përmbledhës me rezultate nga kontrolli i realizuar ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve.

Neni 72

(1) Notat vjetore udhëheqësi i klasës ose i paraleles prindërve ua kumton në takimin prindëror, i cili mbahet tri ditë pas ditës së mbajtjes së këshillit të arsimtarëve në të cilën verifikohen notat vjetore të nxënësve.

(2) Nëse nxënësi ose prindi nuk është i kënaqur me notën vjetore, prindi ka të drejtë që në afat prej tri ditësh nga dita e kumtimit të suksesit, t'i parashtojë kundërshtim në formë të shkruar këshillit të arsimtarëve të shkollës, i cili doemos duhet të jetë i arsyetuar.

(3) Këshilli i arsimtarëve ndaj kundërshtimit vendos ditën e ardhshme nga dita e skadimit të afatit të paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Këshilli i arsimtarëve kundërshtimin mund ta aprovojë, ta refuzojë ose të organizojë rikontroll të njohurive të nxënësit.

(5) Për rikontrollin e njohurisë, drejtori më së voni në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kundërshtimit, formon komision për rikontroll të njohurisë.

(6) Komisioni nga paragrafi (5) i këtij neni përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë - kontrollues.

(7) Kryetar i komisionit, sipas rregullit, është udhëheqësi i klasës, përkatësisht i paraleles ku nxënësi mëson, ndërsa për anëtarë - kontrollues emërohen arsimtarë nga lënda në të cilën bëhet kontrolli i diturive nga radhët e arsimtarëve të shkollës ose nga një shkollë tjetër fillore.

(8) Kryetar dhe anëtar - kontrollues i komisionit nuk mundet të jetë arsimtari i cili e ka përfunduar notën.

(9) Vlerësimi i komisionit është përfundimtar.

Neni 72-a

(1) Nxënësi apo prindi ka të drejtë që të parashtojë ankesë me shkrim te Komisioni i Shkollës dhe të kryejë shikim të testit nga neni 71 paragrafi (7) i këtij ligji, në afat prej tri ditësh nga dita e publikimit të rezultateve.

(2) Komisioni i Shkollës në afat prej tri ditësh prej ditës së pranimit të ankesës nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar që të vendosë për ankesën.

(3) Nëse Komisioni i Shkollës konstaton dallim ndërmjet rezultatit të publikuar dhe rezultatit që e përmban testi nga paragrafi (1) i këtij neni, e merr si rezultat përfundimtar rezultatit e përmbajtur në test dhe për këtë e informon Qendrën Shtetërore të Provimeve.

Neni 73

(1) Nxënësi i cili për shkak të sëmundjes ose për shkaqe të arsyeshme ose të paarsyeshme nuk e përcjell mësimin së paku një të tretën e fondit të orëve mësimore nga lënde të caktuara dhe nuk ka elemente për vlerësim, jep provim klasor sipas lëndëve të parapara.

(2) Për arsyen e shkaqeve nga paragrafi (1) i këtij neni, vendos këshilli arsimtar i shkollës.

Neni 74

(1) Riprovimin ose provimin klasor nxënësi e jep para komisionit të provimeve.

(2) Komisionin nga paragrafi (1) i këtij neni e formon drejtori i shkollës dhe përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë-arsimtarë, nga të cilët njeri anëtar është arsimtar nga lënda përkatëse.

Neni 75

(1) Nxënësi i cili ka sukses të shkëlqyeshëm dhe veçanërisht dallohet me aftësi, dituri dhe shprehi pune më shpejt mund të përparojë.

(2) Nxënësi prej klasës së parë deri në të tretët, me propozimin e arsimtarit të klasës, ndërsa me mendim të bashkëpunëtorëve profesionalë të shkollës dhe pëlqimin e prindit në mënyrë të shpejtuar mund të përparojë dhe të kalojë në klasën që vijon, për çka vendim merr këshilli i arsimtarëve.

(3) Nxënësi prej klasës së katërt deri në klasën e nëntë, me propozimin e kujdestarit të klasës, ndërsa me lejen e këshillit të arsimtarëve dhe pëlqimin e prindit në mënyrë të shpejtuar mund të përparojë, për çka vendim merr këshilli i arsimtarëve.

(4) Nëse nxënësi më shpejt përparon në periudhën e parë, kalon pa dhënien e provimeve për përparim më të shpejtë, ndërsa nëse më shpejt përparon në të dytën, përkatësisht në periudhën e tretë, jep provim për përparim më të shpejtë.

(5) Të drejtën nga paragrafët (2) dhe (3) këtij neni, nxënësi mund ta shfrytëzojë së paku dy herë gjatë arsimit fillor.

(6) Shkolla fillore ka për detyrë të organizojë ndihmë këshillëdhënëse dhe konsultative nga arsimtarët sipas lëndëve përkatëse për nxënësin i cili më shpejt përparon.

Neni 76

Mënyrën e vlerësimit dhe avancimit të nxënësve, organizimit dhe realizimit të riprovimeve, i përcakton ministri me propozim të Byrosë.

VII. ARSIMTARËT, BASHKËPUNËTORËT DHE EDUKATORËT

Neni 77

(1) Punën edukative-arsimore në shkollën fillore, e realizojnë arsimtarët, bashkëpunëtorët profesionalë (pedagogu, psikologu, sociologu, punëtori social, defektologu, bibliotekari) dhe edukatorë.

(2) Arsimtarët, bashkëpunëtorët profesionalë dhe edukatorët në shkollë fillore kanë arsim të lartë përkatës.

(3) Lloji i përgatitjes profesionale të personave të cilët realizojnë punë edukative-arsimore në shkollë fillore rregullohet me normë për kuadrin mësimor të shkollës fillore, që e përcakton ministri.

Neni 78

(1) Punën edukative-arsimore në shkollën fillore të muzikës dhe të baletit e realizojnë arsimtarët, koorepetitorët, bibliotekarët, pedagogët shkollorë dhe psikologët me arsim përkatës.

(2) Lloji i përgatitjes profesionale të personave të cilët realizojnë punë edukative-arsimore në shkollën fillore të muzikës dhe të baletit rregullohet me normë për kuadrin mësimor të shkollat fillore të muzikës dhe të baletit, që e përcakton ministri.

Neni 79

(1) Punën edukative-arsimore në shkolla dhe paralele të veçanta në shkollat fillore e realizojnë arsimtarët, defektologët, bibliotekarët, edukatorët, pedagogët shkollorë dhe psikologët me arsim përkatës.

(2) Lloji i përgatitjes profesionale të personave të cilët e realizojnë punën edukative-arsimore në shkolla të veçanta dhe klasë të veçanta në shkollat fillore rregullohet me normë për kuadrin mësimor në shkolla të veçanta dhe klasë të veçanta në shkollat fillore, që e përcakton ministri.

Neni 79-a

(1) Personi i cili e ka kryer arsimin e lartë në grup jo mësimor në studime për arsimtar, përkatësisht në studime që nuk kanë drejtim mësimor, mund të punësohet në shkollë fillore, përveç në mësimin klasor, vetëm nëse arrin përgatitje pedagogjike psikologjike dhe metodike në institucione të akredituara të arsimit të lartë.

(2) Përgatitja pedagogjike psikologjike dhe përgatitja metodike arrihet nëpërmjet ndjekjes së mësimit dhe dhënies së provimeve, si dhe realizimi i së paku 45 ditëve mësim praktik në shkollë fillore.

(3) Për mësim praktik nga paragrafi (2) i këtij neni, dhjetë ditë para fillimit me mësimin praktik, personi të Inspektorati Shtetëror i Arsimit dorëzon plan dhe orar për realizimin e mësimit praktik, të verifikuar nga institucioni i arsimit të lartë në të cilin kryhet përgatitja pedagogjike - psikologjike dhe metodike dhe shkolla në të cilën do të realizohet mësimi praktik.

(4) Për realizimin e mësimit praktik nga paragrafi (2) i këtij neni, personi merr mendim nga mentori në shkollën në të cilën do të realizohet mësimi praktik. Mentorin e cakton drejtori i shkollës.

(5) Inspektorati Shtetëror i Arsimit kryen kontroll mbi zbatimin dhe realizimin e planit dhe orarit nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Për dhënien e provimeve nga paragrafi (2) i këtij neni, kandidati fiton 30 kredi sipas SETK-ut.

(7) Akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë që do ta realizojnë mësimin dhe dhënien e provimeve për arritjen e përgatitjes pedagogjike psikologjike dhe metodike, e kryen ministri.

(8) Mënyrën e ndjekjes së mësimit, dhënies së provimeve për përgatitje pedagogjike psikologjike dhe metodike, si dhe mënyrën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë nga paragrafi (7) i këtij neni, i përcakton ministri.

(9) Lartësinë e shpenzimeve për marrjen e përgatitjes pedagogjike - psikologjike dhe përgatitjes metodike të institucioneve me arsim të lartë të akredituara, e përcakton ministri në bazë të shpenzimeve reale për marrjen e përgatitjes pedagogjike - psikologjike dhe përgatitjes metodike.

Neni 79-b [5](#)

(1) Në shkollë fillore vendet e punës të të punësuarve janë:

- nëpunës administrativë,
- dhënës të shërbimeve publike në arsimin fillor dhe
- persona ndihmës teknikë.

Neni 79-v [6](#)

(1) Të punësuarit në shkollat fillore që kryejnë punë nga natyra administrative për realizim të veprimtarisë së arsimit fillor kanë status të nëpunësve administrativë.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen nivelet vijuese të vendeve të punës:

- kategoria V – Profesionale
- niveli V1 këshilltar për punë juridike normative (sekretar) dhe

- kategoria G - ndihmëse-profesionale
- niveli G1 referent i pavarur (sekretar teknik që kryen punë arkëtari dhe punë tjera të ngjashme, arkëtar që kryen edhe punë administrative edhe punë të ngjashme) dhe
- niveli G2 referent i lartë (arkëtar, sekretar teknik dhe të tjerë).

Neni 79-g [7](#)

(1) Të punësuarit në shkollat fillore që kryejnë punë nga veprimtaria arsim fillor, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në arsimin fillor dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) të këtij neni përcaktohen nivelet vijuese të kategorive dhe niveleve të vendeve të punës:

- kategoria K - mësimdhënës
- niveli K1 këshilltar (mësimdhënës-këshilltar, mësimdhënës-këshilltar në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme dhe mësimdhënës-këshilltar në shkollë për arsimim artistik që realizojnë mësim individual dhe grupor),
- niveli K2 mentor (mësimdhënës-mentor, mësimdhënës-mentor në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme dhe mësimdhënës-mentor në shkolla për arsimim artistik që realizojnë mësim individual dhe grupor),
- niveli K3 mësimdhënës (mësimdhënës, mësimdhënës në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme, mësimdhënës në shkolla për arsimim artistik që realizojnë mësim individual dhe grupor) dhe
- niveli K4 praktikant (mësimdhënës-praktikant, mësimdhënës-praktikant në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme, mësimdhënës-praktikant në shkolla për arsimim artistik që realizojnë mësim individual dhe grupor),
- kategoria LL - bashkëpunëtorë profesionalë
- niveli LL1 këshilltar (bashkëpunëtor profesional-këshilltar, bashkëpunëtor profesional-këshilltar në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme),
- niveli LL2 mentor (bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-mentor në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme),
- niveli LL3 bashkëpunëtor profesional (bashkëpunëtor profesional, bashkëpunëtor profesional në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme),
- niveli LL4 praktikant (bashkëpunëtor profesional-praktikant, bashkëpunëtor profesional-praktikant në shkolla me nxënës me nevoja të posaçme) dhe
- kategoria M edukator
- niveli M1 edukator

Neni 79-d [8](#)

(1) Të punësuarit në shkollat fillore që kryejnë punë ndihmëse-teknike, kanë status të personave ndihmës-teknik dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) të këtij neni përcaktohen nëngrupet, kategoritë dhe nivelet vijuese të vendeve të punës:

- nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 pastrues, ndezësmanipulues i kazanëve me avull, ekonom-shtëpiar, haus mjeshër dhe të tjerë,
- nëngrupi 2 kategoria A niveli A1 rojtar dhe të tjerë,
- nëngrupi 3 kategoria A niveli A1 shofer dhe të tjerë,
- nëngrupi 4 kategoria A niveli A1 servuese-enëlarëse, gjellëbërës dhe të tjerë dhe
- nëngrupi 5 kategoria A niveli A1 punëtor i përgjithshëm, pastruese, përkujdesës dhe të tjerë.

Neni 79-gj [9](#)

(1) Drejtori, me mendimin paraprak të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe pëlqim paraprak nga kryetari i komunës, në territorin e së cilës është shkolla fillore dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton plan vjetor për punësim në shkollat fillore të komunës për vitin e ardhshëm, në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

(2) Drejtori, me mendimin paraprak të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe pëlqim paraprak nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton plan vjetor për punësim në shkollat fillore shtetërore për vitin e ardhshëm, në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

1. Themelimi i marrëdhënies së punës

Neni 80

(1) Arsimitar, punëtor profesional dhe edukator mundet të punësohet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme, i plotëson edhe kushtet e veçanta si vijon:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë arsim përkatës,
- ta njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe
- të ketë të dhënë provim profesional për arsimtar, bashkëpunëtor profesional, përkatësisht për edukator.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni në shkollat dhe paralelet në të cilat mësimi realizohet në gjuhën dhe alfabetin të ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, përveç arsimtarëve për lëndën gjuhën maqedonase, duhet doemos ta njohin edhe gjuhën dhe alfabetin në të cilën realizohet mësimi.

(3) Drejtori i shkollës fillore formon komision të përbërë prej tre anëtarësh nga radhët e kuadrit edukator-arsimor i cili bën kontrollimin e njohjes së gjuhës së arsimtarëve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Në shpalljen publike për themelimin e marrëdhënies së punës për arsimtar, bashkëpunëtor profesional, përkatësisht edukues, mund të paraqitet edhe personi që nuk e ka dhënë provimin profesional dhe të themelojë marrëdhënie pune në kohë të caktuar pune deri në fund të vitit shkollor.

(5) Pa provim të dhënë profesional, nuk mund të themelohet marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.

Neni 81

Arsimtare për lëndët për të cilat mësimi realizohet në gjuhë të huaj mund të jenë edhe persona shtetas të huaj të cilët kanë arsim të llojit përkatës dhe e njohin gjuhën në të cilën realizohet mësimi, për çka pëlqim jep Ministria.

Neni 82

(1) Arsimtari, bashkëpunëtori profesional dhe edukatori zgjidhen me shpallje publike.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të themelojnë marrëdhënie pune dhe pa shpallje publike, në kohë të caktuar, së shumti deri në tre muaj.

(3) Shpallja publike nga paragrafi (1) e këtij neni botohet së paku në dy gazeta ditore prej të cilave së paku në një prej gazetave që botohen në gjuhën maqedonase dhe në gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja.

(4) Gjatë zgjedhjes së bashkëpunëtorëve profesionale, edukatorëve dhe kuadrit tjetër mësimor ku zbatohet parimi i përfaqësimit përkatës dhe adekuat të qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive dhe respektimit të kritereve të profesionalizmit dhe kompetencës.

(5) Shkolla fillore para se të shpallë konkurs publik për punësim, nevojën për punëtor në kohë të caktuar e siguron me marrjen e punëtorit me arsim përkatës dhe me fond të paplotë të orëve mësimore nga shkolla tjetër publike në komunë, ndërsa për Qytetin e Shkupit nga shkollat tjera në komunat në Qytetin e Shkupit.

(6) Evidencën për kuadrin e punësuar nga paragrafi (5) i këtij neni, e mban Ministria, në bazë të përmbledhjes së të dhënave personale të të punësuarve në shkolla nga neni 15-b pika 3 e këtij ligji.

Neni 83

(1) Arsimitarët të cilët punojnë në rajonin e shkollës fillore në vendbanim me më pak se 10 nxënës dhe realizojnë mësim me program të shkurtuar themelojnë marrëdhënie punë në kohë të caktuar me fond të plotë të orëve deri në realizimin e programit të shkurtuar.

(2) Arsimitarët mund të themelojnë marrëdhënie pune në kohë të caktuar deri në fund të vitit mësimor, nëse në shpalljen publike nuk paraqitet person i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj.

(3) Arsimitarët mund të themelojnë marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, më të shkurtër nga orari i plotë e punës, nëse vëllimi i punës paraqet së paku gjysmën e orarit të punës në javën e punës në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Neni 84

Arsimitarët, bashkëpunëtorët profesionale dhe edukatorët i zgjedh drejtori i shkollës me mendim paraprak të këshillit të shkollës.

2. Stazhi i praktikantit

Neni 85

(1) Mësimdhënësi, bashkëpunëtori profesional ose edukatori i cili për herë të parë punësohet në shkollë fillore është mësimdhënës-praktikant, bashkëpunëtor profesional-praktikant, përkatësisht edukator-praktikant.

(2) Stazhi i praktikantit zgjat një vit.

(3) Gjatë kohës së stazhit të praktikantit, praktikantit i takon rrogë në lartësi prej 80% nga rroga e mësimdhënësit, bashkëpunëtorit profesional, përkatësisht edukatorit.

(4) Gjatë kohës së stazhit të praktikantit, personat nga paragrafi (1) i këtij neni, aftësohen për punë të pavarur edukative – arsimore, përkatësisht profesionale nëpërmjet përvetësimit të programit për provim profesional.

(5) Praktikanti gjatë kohës së stazhit të praktikantit bashkëpunon me mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionale, përkatësisht edukatorët dhe përgatitet për provim profesional.

(6) Gjatë kohës së stazhit të praktikantit, praktikantin e ndjek mentori.

(7) Mentorin e praktikantit e cakton drejtori i shkollës nga radhët e mësimdhënësve, përkatësisht bashkëpunëtorëve profesionale ose edukatorëve të cilët kryejnë punë për të cilën aftësohet praktikanti dhe kanë titull mësimdhënës mentor apo mësimdhënës-këshilltar.

(8) Mentori praktikantit i përpilon program i cili përfshin përgatitje metodike, didaktike dhe përgatitje tjetër të nevojshme për aftësimin e mësimdhënësit edhe për dhënien e provimit. Mentori përpilon raport për punën e praktikantit.

(9) Personi i njëjtë nuk mund të jetë mentor në të njëjtën kohë i më tepër se dy praktikantëve.

(10) Për kryerjen e punës si mentor, shkolla mentorit i paguan kompensim në lartësi prej 10 % të rrogës, që e merr praktikanti pas përfundimit të stazhit të praktikantit.

(11) Praktikanti pas kalimit të stazhit të praktikantit e jep provimin profesional para komisionit të formuar nga ministri.

(12) Praktikantit pas kalimit të stazhit të praktikantit, e para dhënies së provimit profesional, i bëhet vlerësim i karakteristikave për përshtatshmëri me punë me fëmijë dhe adoleshentë në veprimtarinë edukative arsimore (në tekstin e mëtejme: vlerësim i karakteristikave).

(13) Shpenzimet për dhënien e vlerësimit të karakteristikave janë në llogari të praktikantit. Lartësinë e shpenzimeve e përcakton ministri në bazë të shpenzimeve reale për vlerësimin e karakteristikave.

(14) Për zbatimin e vlerësimit të karakteristikave, Ministria angazhon persona të licencuar profesionalë të institucionit të pavarur të akredituar profesional.

(15) Personi i angazhuar i licencuar profesional nga paragrafi (14) të këtij neni, në mendimin nga vlerësimi i realizuar i karakteristikave e vlerëson përshtatshmërinë me punën me fëmijë dhe adoleshentë në veprimtarinë edukative arsimore të praktikantit dhe të njëjtin e dorëzon te Shërbimi Pedagogjik.

(16) Praktikantit i cili ka marrë vlerësim pozitiv të karakteristikave, Shërbimi Pedagogjik i jep vërtetim.

(17) Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (16) të këtij neni, e përcakton ministri me propozim të Shërbimit Pedagogjik.

(18) Praktikanti për dhënien e provimit profesional paguan kompensim, lartësinë e të cilit e përcakton ministri në bazë të shpenzimeve reale për realizimin e provimit profesional.

(19) Programin për dhënien e provimit profesional të praktikantit dhe mënyrën e zbatimit të provimit i përcakton ministri.

3. DETYRAT ZYRTARE TË ARSIMTARIT DHE BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL

Neni 86

(1) Detyrat zyrtare të arsimtarit në shkollën fillore përfshijnë mësim dhe lloje të tjera të punës së organizuar me nxënësit, përgatitje për mësim, kontrollim dhe notim të detyrave me shkrim dhe detyrave tjera që janë të nevojshme për zbatimin e programit edukativ-arsimor.

(2) Mësimdhënësi në shkollën fillore mësimin e realizon në mënyrë interaktive, që nënkupton përfshirje aktive të nxënësve në procesin e punës edukativo-arsimore.

(3) Mënyrën për realizimin e mësimit interaktiv e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(4) Koha që ndahet për përgatitjen e mësimit dhe punës tjetër edukative-arsimore të arsimtarët përfshin:

- planifikimin e mësimit në formë të shkruar ose elektronik dhe zgjedhjen e mjeteve mësimore;
- përgatitjen e mjeteve didaktikë ndihmesë,

- bashkëpunimin me prindërit,
- bashkëpunimin me organet profesionale të shkollës,
- kryerjen e detyrave të kujdestarit të klasës,
- pjesëmarrjen në kontroll të brendshëm në arritjet e nxënësve,
- pjesëmarrje në kontrollimin ekstern të arritjeve të suksesit të nxënësve,
- pjesëmarrjen në arsimin profesional dhe didaktik-metodik dhe përsosje,
- grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave në lidhje me kryerjen e punëve edukative-arsimore dhe punëve të tjera,
- mbajtjen e dokumentacionit pedagogjik dhe evidencën,
- këshillimin e nxënësve,
- këshillimin e praktikantëve,
- rregullimin e kabineteve, përmbledhjeve, punëtorive shkollore, ushtrimoreve, shesheve të lojërave, plantacioneve e të tjera,
- organizimin e aksioneve të ndryshme kulturore sportive dhe aksioneve të tjera të përgjithshme dhe humane në të cilat marrin pjesë nxënësit,
- mbajtjen e aktiviteteve të lira të nxënësve dhe punë me nxënësit në projekte dhe kërkime,
- përgatitjen dhe mbajtjen e ekskursioneve, shëtitjeve, garave, mësimi në natyrë, pushimin veror, fushimin që e organizon shkolla dhe
- kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara me programin vjetor për punë.

(5) Ndalohet keqtrajtimi psikik dhe fizik i mësimitdhënësit, bashkëpunëtorit profesional dhe edukatorit.

Neni 87

Detyrat zyrtare të bashkëpunëtorit profesional në shkollën fillore përfshijnë punët profesionale:

- regjistrimin e nxënësve dhe përcjelljen e zhvillimit të tyre në shkollën fillore,
- përcjelljen me kohë të vaksinimit të nxënësve,
- planifikimin e mësimi dhe punës së tjetër edukative-arsimore,
- zhvillimin e programeve, procedurave dhe instrumenteve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe vetëvlerësimin e shkollës,
- pjesëmarrjen në organizimin e arsimimit profesional dhe didaktik-metodik dhe përsosje,
- bashkëpunimin me prindërit,
- përkrahjen e punës së bashkësisë së nxënësve,
- zbatimin e dispozitave për realizimin e drejtave dhe detyrimeve të nxënësve, avancimin dhe kumtimin e masave pedagogjike për shkeljen e rregullave të shkollës dhe rendit të shtëpisë së shkollës fillore,
- përkrahjen e aktivave profesionale të arsimtarëve për zgjedhjen e teksteve shkollore dhe revistave për fëmijë dhe literaturë tjetër që shfrytëzohet në shkollë,
- organizimin e praktikës pedagogjike dhe metodike të studentëve të fakulteteve mësimore,
- përkrahjen e arsimtarëve për punën individuale me nxënësit,
- organizimin dhe udhëheqjen e punës së bibliotekës së shkollës,
- orientimin profesional të nxënësve,
- përkrahjen e arsimtarëve për mbajtjen e dokumentacionit pedagogjik dhe evidencën shkollës fillore dhe
- mbajtjen e kartonit pedagogjik për arsimtarët.

Neni 88

(1) Për arsimtaret në shkollën fillore fondi javor i orëve mësimore për arsimtarin klasor është prej 20 deri në 23 orë mësimore në të cilat hyn edhe koha për pranimin e organizuar të nxënësve para dhe pas mësimi.

(2) Në fondin javor të orëve mësimore nga paragrafi (1) i këtij neni nuk hyjnë orët për mësim plotësues dhe shtesë.

(3) Fondi javor i orëve mësimore për arsimtarin e lëndës është prej 20 deri në 23 orë ku nuk bëjnë pjesë orët për mësim plotësues dhe shtesë.

Neni 89

Orari i punës së bashkëpunëtorit profesional në shkollën fillore gjatë javës është 40 orë.

Neni 90

(1) Vëllimin e detyrimeve të punës në kornizat e orarit të punës së arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionale dhe edukatorëve gjatë punës javore prej 40 orësh, e përcakton ministri

(2) Fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, shfrytëzimin e pushimit ditor dhe vjetor të personave nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet me statutin e shkollës.

4. PËRKRYERJE PROFESIONALE, AFTËSIMI DHE AVANCIMI

Neni 91

(1) Drejtori, arsimtari dhe bashkëpunëtori profesional në shkollën fillore gjatë punës së vetë janë të obliguar të përkryhen në mënyrë profesionale.

(2) Ministri në bashkëpunim me Byronë dhe Qendrën Shtetërore të Provimeve, miraton program vjetor për përsosjen dhe avancimin profesional të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.

(3) Për përsosjen dhe aftësimin profesional të secilit arsimtar dhe bashkëpunëtor profesional, mbahet dosje profesionale.

(4) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së dosjes profesionale i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(5) Mënyrën e kryerjes së evalvimit të dosjes profesionale nga paragrafi (3) i këtij neni, e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(6) Përkryerja profesionale realizohet përmes programeve të akredituara për trajnim të cilat i realizojnë institucionet publike dhe private, shoqatat e qytetarëve dhe shoqëritë tregtarë, programet e të cilëve janë të akredituara.

(7) Akreditimin e programeve për trajnimin nga paragrafi (2) i këtij neni e bën Byroja në bazë të shpalljes publike.

(8) Që të akreditohet programi për trajnim për përkryerje profesionale, institucioni publik dhe privat, shoqata e qytetarëve dhe shoqëria tregtare, të cilat e bëjnë trajnimin duhet t'i përmbushin kushtet në vijim:

- t'i përmbushin kërkesat për programin e përcaktuar në shpalljen publike;
- të kenë përvojë në realizimin e trajnimeve për përkryerje profesionale;
- të ketë siguruar lokale të pajisura në mënyrë përkatëse me mjete ndihmëse mësimore për realizimin bashkëkohor të trajnimeve, dhe
- të kenë angazhuar trajnues për lëmin përkatës të cilët kanë së paku arsim sipëror dhe përvojë në realizimin e trajnimit.

(9) Akreditimi i programit të trajnimit për përkryerje profesionale vlen dy vjet dhe gjatë realizimit të programit Byroja bën evoluimin e saj.

(10) Për programin e akredituar të trajnimit për përkryerje profesionale të drejtorit, të arsimtarit dhe të bashkëpunëtorit profesional në shkollën fillore, Byroja mban evidencë.

Neni 92

10

(1) Arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollën fillore përsosen, aftësohen dhe avancohen në tituj.

(2) Arsimtari dhe bashkëpunëtori profesional të cilët për herë të parë punësohen në shkollë janë me titull arsimtar – praktikant dhe bashkëpunëtor profesional – praktikant.

(3) Arsimtari – praktikant mund të avancohet në titujt arsimtar, arsimtar - mentor dhe arsimtar – këshilltar.

(4) Bashkëpunëtori profesional–praktikant mund të avancohet në titujt bashkëpunëtor profesional, bashkëpunëtor profesional – mentor dhe bashkëpunëtor profesional–këshilltar.

(5) Avancimin e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në titujt arsimtar, arsimtar – mentor, bashkëpunëtor profesional dhe bashkëpunëtor profesional – mentor e bën komisioni shkollor që e formon drejtori i shkollës.

(6) Komisioni nga paragrafi (5) i këtij neni, përbëhet nga një arsimtar i klasës dhe arsimtar i lëndës mësimore, përkatësisht psikologu i shkollës, një prind, drejtori i shkollës, anëtari i këshillit shkollor, i cili është përfaqësues nga themeluesi dhe këshilltari i Byrosë.

(7) Arsimitarët e klasës dhe të lëndës për anëtarë të komisionit nga paragrafi (6) i këtij neni, i zgjedh këshilli i arsimtarëve në shkollë, prindin e zgjedh këshilli i prindërve të shkollës, ndërsa anëtarin e këshillit shkollor e zgjedh këshilli shkollor.

(8) Gjatë avancimit të arsimtarëve në titull përkatës nga paragrafi (3) i këtij neni, komisioni shkollor detyrimisht i merr parasysh rezultatet nga kontrolli ekstern të përmbajtura në raportin për punën e arsimtarëve, si dhe nga evalvimi i dosjes profesionale të arsimtarit.

(9) Gjatë avancimit të bashkëpunëtorëve profesionalë në titull përkatës nga paragrafi (4) i këtij neni, komisioni shkollor detyrimisht i merr parasysh rezultatet nga evalvimi i dosjes profesionale të bashkëpunëtorit profesional.

(10) Arsimitari dhe bashkëpunëtori profesional i cili është i pakënaqur nga zgjedhja e bërë për avancim në titull në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni, ka të drejtë kundërshtimi në këshillin shkollor në afat prej tetë ditësh nga dita e publikimit të listës së arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të cilët avancohen në titull.

(11) Avancimin e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në tituj arsimtar – këshilltar dhe bashkëpunëtor profesional – këshilltar e bën komisioni i formuar nga ministri.

(12) Gjatë avancimit të arsimtarëve në titullin përkatës nga paragrafi (11) i këtij neni, komisioni i formuar nga ministri detyrimisht i merr parasysh rezultatet nga kontrolli ekstern të përmbajtura në raport për punën e arsimtarëve, si dhe nga evalvimi i dosjes profesionale të arsimtarit.

(13) Gjatë avancimit të bashkëpunëtorëve profesionalë në titullin përkatës nga paragrafi (11) i këtij neni, komisioni i formuar nga ministri detyrimisht i merr parasysh rezultatet nga evalvimi i dosjes profesionale të bashkëpunëtorit profesional.

(14) Shkolla fillore pas mbarimit të çdo viti shkollor mund të bëjë avancim të dy të punësuarve nga radhët e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në çdonjërin prej titujve nga paragrafi (5) i këtij neni dhe mund të propozojë dy të punësuar nga radhët e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë që të avancohen në titujt nga paragrafi (11) i këtij neni me propozim të këshillit të arsimtarëve, nëse ka deri 50 arsimtarë dhe bashkëpunëtorë profesionalë të punësuar.

(15) Shkolla fillore pas mbarimit të çdo viti shkollor mund të bëjë avancim të tre të punësuarve nga radhët e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në çdo titull nga paragrafi (5) i këtij neni dhe mund të propozojë tre të punësuar nga radhët e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë që të avancohen në titujt nga paragrafi (11) i këtij neni me propozim të këshillit të arsimtarëve, nëse ka mbi 51 arsimtarë dhe bashkëpunëtorë profesionalë të punësuar.

(16) Arsimitari dhe bashkëpunëtori profesional mund të avancohet në titullin vijues pas katër vitesh në procedurë të përcaktuar me këtë ligj.

(17) Arsimitari dhe bashkëpunëtori profesional i cili është i pakënaqur nga zgjedhja e bërë për avancim në titull në pajtim me paragrafin (11) të këtij neni, ka të drejtë kundërshtimi në

Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga dita e publikimit të listës së arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të cilët avancohen në titull.

Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë vendos për ankesën e parashtruar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(18) Rroga e arsimtarit dhe bashkëpunëtorit profesional është sipas titullit të marrë.

(19) Mënyrën e përsosjes profesionale, aftësimit dhe avancimit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në titull e përcakton ministri me propozim të Byrosë, Qendrës Shtetërore të Provimeve dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

Neni 93

(1) Të punësuarit në shkollën fillore në çdo tri vjet duhet doemos të kontrollohen sistematikisht.

(2) Çdo personi i cili lëngon nga sëmundje shpirtërore, alkoolizëm dhe narkomani i ndërpritet marrëdhënia e punës në shkollën fillore.

(3) Përcaktimi i aftësive psikofizike të të punësuarve në shkollën fillore, përkatësisht lëngimi nga sëmundje të caktuara shpirtërore, alkoolizëm dhe narkomani bëhet në pajtim me dispozitat nga sfera e mbrojtjes shëndetësore.

Neni 94

(1) Arsimtarit, bashkëpunëtorit profesional dhe edukatorit për punën e të cilëve ka pushuar nevoja për shkaqe afariste, nuk mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës, përderisa nuk i sigurohet njëra nga drejtat në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

(2) Mënyra dhe kriteret për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të shkaqeve afariste vërtetohet me marrëveshjen kolektive.

Neni 95

(1) Gjatë ndryshimeve në vëllimin e punës në shkollën fillore që paraqiten për shkak të ndryshimit në planin mësimor dhe programet, organizimin e punës, numrin e paraleleve dhe ndryshimeve të tjera, marrëdhënia e punës së arsimtarët në shkollën fillore ndryshohet nga marrëdhënia e punës në kohë të pacaktuar me orar të plotë pune në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me orar pune më të shkurtër se orari i plotë dhe anasjelltas.

(2) Drejtori është i detyruar që në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni arsimtarët t'i lëshojë aktvendim të ri për orarin e punës.

5. VLERËSIMI I ARSIMTARËVE

Neni 96

(1) Për arsimtarët, bashkëpunëtorët profesionalë ose edukatorët, të cilët në realizimin e procesit edukativ-arsimor nuk tregojnë rezultate të kënaqshme, Byroja, këshilli i prindërve ose Inspektorati Shtetëror i Arsimit ngrit iniciative në këshillin e shkollës për rishqyrtimin e aftësive të tyre për realizimin e detyrimeve të punës nëpërmjet kryerjes së vlerësimit të karakteristikave të të punësuarit për përshtatshmëri për punë me fëmijë dhe adoleshentë në veprimtarinë edukativo-arsimore (testi i personalitetit).

(2) Byroja, këshilli i prindërve ose Inspektorati Shtetëror i Arsimit ngritin iniciative në këshillin e shkollës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës edhe për arsimtarët në shkollat fillore të cilët bëjnë përgatitje dhe aktivitete tjera të nxënësve nga shkolla të cilët përcjellin ligjërata pas mbarimit të orarit të punës, ndërsa nuk janë përcaktuar me programin vjetor për punë.

(3) Iniciativa nga paragrafët (1) dhe (2) i këtij neni doemos duhet të përmbajë arsyetim për shkaqet për të cilët ngrihet.

(4) Nëse iniciativa nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni është ngritur nga këshilli i prindërve, këshilli i shkollës para se të shqyrtojë iniciativën, detyrimisht kërkon mendim nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

(5) Nëse këshilli shkollor e pranon iniciativën nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni drejtorit i paraqet propozim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së arsimtarit, bashkëpunëtorit profesional ose edukatorit, në afat prej shtatë ditësh.

(6) Drejtori është i detyruar të veprojë ndaj propozimit nga paragrafi (4) i këtij neni në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes së propozimit dhe të miratojë akt për ndërprerje të marrëdhënies së punës të arsimtarit dhe bashkëpunëtorit profesional.

(7) Kundër aktit të drejtorit nga paragrafi (6) i këtij neni, arsimtari dhe bashkëpunëtori profesional mund të parashtrijë aktpadi te gjykata kompetente.

Neni 97

(1) Në bazë të rezultateve nga kontrolli ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve vlerësohet objektiviteti dhe profesionaliteti i arsimtarit në vlerësimin e të arriturave të suksesit të nxënësit.

(2) Vlerësimi nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet me krahasimin e rezultateve të kontrollit ekstern të arritjeve të nxënësit me notën përfundimtare të nxënësit për lëndën përkatëse për çfarë Qendra Shtetërore e Provimeve përpilon raport përmbledhës me rezultatet nga kontrolli i zbatuar ekstern i të arriturave të suksesit të nxënësve.

- (3) Raporti nga paragrafi (2) i këtij neni përpilohet në bazë të vlerës mesatare të shprehur në përqindje nga rezultatet e kontrollit ekstern të arritjeve të nxënësve me notat vjetore të nxënësit për të cilat nuk ka shmangie dhe për të cilat shmangia është më e madhe se një notë.
- (4) Me përjashtim, raporti nga paragrafi (2) i këtij neni, zgjerohet me arsimtarë që kanë shmangie nga treguesit e fituar si arsimtari i fundit i listës.
- (5) Përqindja e shmangieve më të mëdha të treguesve të fituar është 100%, kur ka shmangie prej katër notash nga nota e marrë nga kontrolli dhe nota vjetore nga arsimtari.
- (6) Përqindja e shmangieve më të vogla të treguesve të fituar është 0%, kur nuk ka shmangie nga nota e marrë nga kontrolli dhe nota vjetore nga arsimtari.
- (7) Në bazë të raportit të publikuar me rezultate nga kontrollet e realizuara eksterne të arritjeve të suksesit të nxënësve, 20% të arsimtarëve të cilët ka shmangie më të vogla në treguesit e fituar, u rritet rroga për vitin e ardhshëm për 15% nga rroga që e kanë marrë.
- (8) Në bazë të raportit të publikuar me rezultate nga kontrollet e realizuara eksterne të arritjeve të suksesit të nxënësve, 20% të arsimtarëve të cilët ka shmangie më të mëdha në treguesit e fituar, u zvogëlohet rroga për vitin e ardhshëm për 15% nga rroga që e kanë marrë.
- (9) Me përjashtim nga paragrafi (7) i këtij neni nëse në raportin e publikuar me rezultatet nga kontrolli i realizuar ekstern i suksesit të nxënësve numri i mësimdhënësve të cilët ka shmangie më të vogla në treguesit e marrë është më i madh se 20%, të gjithë mësimdhënësve në mënyrë të barabartë u rritet rroga në lartësi të mjeteve që janë nga mësimdhënësit të cilët ka shmangie më të mëdha në treguesit e marrë.
- (10) Me përjashtim nga paragrafi (8) të këtij neni, nëse në raportin e publikuar me rezultatet nga kontrolli i realizuar ekstern të suksesit të nxënësve, numri i mësimdhënësve të cilët ka shmangie më të mëdha në treguesit e marrë është më i vogël se 20%, numri i mësimdhënësve të cilëve u rritet rroga është i barabartë me numrin e mësimdhënësve të cilëve u zvogëlohet rroga.
- (11) Dispozita nga paragrafi (9) i këtij neni ka të bëjë me mësimdhënësit objektiviteti i të cilëve kontrollohet gjatë vlerësimit të arritjeve të suksesit të nxënësve në lëndët mësimore me të cilat nxënësit fitojnë shkathtësi, përkatësisht për lëndët mësimore për të cilat nuk mund të kryhet kontroll ekstern i arritjes së suksesit të nxënësve.
- (12) Raportin me rezultate nga kontrolli i realizuar ekstern i arritjeve të suksesit të nxënësve, Qendra Shtetërore e Provimeve e publikon në ueb faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve dhe të Ministrisë në javën e dytë të muajit shtator në vitin rrjedhës. Me përjashtim, nëse në periudhën kur publikohet raporti nga ky paragraf mbahen zgjedhje për President të Republikës së Maqedonisë, për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht për anëtarë të këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për zgjedhje të kryetarit të komunës dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit, raporti publikohet ditën e parë të ardhshme pas përfundimit të zgjedhjeve.

(13) Për arsimtarët nga paragrafi (8) i këtij neni, sigurohet ndihmë këshillëdhënëse profesionale përkatëse nga Byroja.

(14) Arsimtarit të cilit edhe pas dy vitesh nga marrja e ndihmës profesionale, sërish do të jetë në grupin e arsimtarëve të cilët ka shmangie më të mëdha në treguesit e fituar, i ndërpritet marrëdhënia e punës.

(15) Aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsimtarin, miraton drejtori i shkollës fillore.

(16) Kundër aktvendimit të drejtorit nga paragrafi (15) i këtij neni, arsimtari mund të parashtojë padi në gjykatën kompetente.

(17) Aktvendim për rritjen, përkatësisht zvogëlimin e rrogës së arsimtarit në pajtim me paragrafët (7), (8) dhe (9) të këtij neni, miraton drejtori i shkollës. Pagesa e rrogës me rritje, përkatësisht me zvogëlim fillon nga 1 janari i vitit të ardhshëm pas publikimit të raportit për punën e arsimtarëve.

(18) Aktvendimi nga paragrafi (17) i këtij neni dorëzohet në Ministri deri më më së voni 15 ditë nga dita e publikimit të raportit përmbledhës me rezultate nga kontrolli i realizuar eksterne i arritjeve të suksesit të nxënësve të vitit rrjedhës, e do të fillojë të zbatohet nga janari i vitit të ardhshëm. [11](#)

(19) Mënyrën e përpilimit të raportit përmbledhës me rezultate nga kontrollet e kryera eksterne të arritjeve të suksesit të nxënësve, si dhe mënyrën e përcaktimit të përqindjes së shmangieve më të mëdha apo më të vogla nga treguesit e fituar, i përcakton ministri me propozim të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

VIII. DOKUMENTACIONI PEDAGOGJIK DHE EVIDENCA

Neni 98

Shkolla fillore grumbullon, përpunon, ruan, ndërmjetëson dhe përdor të dhëna që përmbahen në dokumentacionin pedagogjik dhe evidencë në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 99

(1) Dokumentacioni pedagogjik në kuptimin e këtij ligji përfshin: librin kryesor të nxënësve, listat e evidentimit për suksesin e nxënësve, legjitimacionin e nxënësve, dëftesën dhe fletëtransferimin.

(2) Libri kryesor i nxënësve është dokument me vlerë të përhershme.

Neni 100

(1) Dokumentacioni pedagogjik nga neni 99 paragrafi (1) të këtij ligji mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik.

(2) Për nxënësit e pjesëtarëve të bashkësive të cilët mësimin e realizojnë në gjuhë dhe alfabet të ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, dokumentacioni pedagogjik nga paragrafi (1) i këtij neni mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilin realizohet mësimi.

(3) Ditari i paraleles mbahet në gjuhën dhe alfabetin në të cilin realizohet mësimi.

(4) Ditarin e paraleles mësimdhënësi e mban në mënyrë të detyrueshme edhe në formë elektronike (e-ditar) në bazë javore, përmes ueb aplikimit që e administron Ministria.

Neni 101

(1) Dëftesa, legjitimacioni i nxënësit dhe fletëtransferimi janë dokumente publike.

(2) Dokumentet publike lëshohen në një ekzemplar. Në rastin kur dokumenti i lëshuar nga paragrafi (1) i këtij neni të humbet ose asgjësohet, shkolla fillore lëshon ekzemplar të ri-dublikatë.

Neni 102

Nxënësi i cili e ka humbur dëftesën mund të kërkojë lëshimin e dokumentit në procedure jashtëprocesore para gjykatës kompetente në rajonin e së cilës është selia ose ka qenë selia e shkollës fillore nëse shkolla fillore e cila e ruan dokumentacionin nuk mund të lëshojë ekzemplar të ri.

Neni 103

Formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit pedagogjik dhe evidencës, si dhe mënyrën e lëshimit e përcakton ministri

IX. TEKSTET SHKOLLORE

Neni 104

(1) Në shkollën fillore për realizimin e edukatës dhe arsimit themelor përdoren tekste shkollore.

(2) Tekstet shkollore botohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

(3) Për nxënësit e pjesëtarë të bashkësive që e ndjekin mësimin në gjuhë dhe alfabet të ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, tekstet shkollore lëshohen në gjuhën dhe alfabetin në të cilën realizohet mësimi.

(4) Nxënësit mund të shfrytëzojnë edhe burime të tjera për mësim (internet, revista, enciklopedi, fjalorë dhe ngjashëm).

Neni 105

(1) Teksti shkollor përpunohet në bazë të planit dhe programit mësimor për klasë dhe lëndë përkatëse dhe Konceptin për tekst shkollor, që me propozimin e Byrosë e verifikon ministri.

(2) Me Konceptin për tekst shkollor përcaktohen bazat shkencore-profesionale dhe metodologjike të tekstit shkollor, funksionet zhvillimore edukative-arsimore, bazat për motivim dhe mësim të pavarur, standardet didaktike-metodike për zgjedhjen dhe sistematizimin e përmbajtjeve, tekstet plotësuese, materiale-vizuale, si dhe përputhshmëria e gjuhës sipas moshës së nxënësve dhe ndërtimit të kulturës gjuhësore. [12](#)

Neni 106

Jashtë fuqisë [13](#)

Neni 107

Jashtë fuqisë

Neni 108

Jashtë fuqisë

Neni 109

Jashtë fuqisë

Neni 110

Jashtë fuqisë

Neni 111

Jashtë fuqisë

Neni 112

Jashtë fuqisë

Neni 113

Jashtë fuqisë

Neni 114

Jashtë fuqisë

Neni 115

Jashtë fuqisë

Neni 116

(1) Ministria mund të marrë pjesë në botimin e teksteve shkollore me tirazh të vogël.

(2) Tekste shkollore me tirazh të vogël janë ato të cilat kanë më së shumti deri në 500 ekzemplarë.

Neni 117

Jashtë fuqisë

Neni 118

Jashtë fuqisë

Neni 119

Jashtë fuqisë

Neni 120

Jashtë fuqisë

Neni 121

Jashtë fuqisë

Neni 122

Jashtë fuqisë

Neni 123

Jashtë fuqisë

X. ORGANET E ADMINISTRIMIT, UDHËHEQJES DHE ORGANET PROFESIONALE TË SHKOLLËS FILLORE

1. ORGANI I ADMINISTRIMIT TË SHKOLLËS FILLORE

Neni 124

- (1) Organ i administrimit të shkollës fillore është këshilli i shkollës.
- (2) Këshilli i shkollës fillore përbëhet nga nëntë anëtarë edhe atë: tre përfaqësues të arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe edukatorëve nga shkolla, tre përfaqësues të prindërve të nxënësve, dy përfaqësues nga themeluesi dhe një përfaqësues nga Ministria.
- (3) Mandati i anëtarëve të këshillit të shkollës është tre vjet, ndërsa mandati i përfaqësuesve të prindërve është për periudhën deri në mbarimin e shkollës fillore të fëmijë së tij, por jo më shumë se tre vjet.
- (4) Këshilli i shkollës nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryetarin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, me votim të fshehtë.
- (5) Vendimet e këshillit të shkollës merren me shumicën e votave të anëtarëve.

Neni 125

- (1) Arsimtarët, bashkëpunëtorët profesionalë dhe edukatorët në shkollën fillore përfaqësuesit e tyre në këshillin e shkollës i zgjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
- (2) Përfaqësuesit e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe edukatorëve të këshillit të shkollës i zgjedh këshilli i arsimtarëve.
- (3) Përfaqësuesit e prindërve i zgjedh këshilli i prindërve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
- (4) Procedura për zgjedhjen e përfaqësuesve të të punësuarve në shkollën fillore dhe prindërit në këshillin e shkollës përcaktohet me statutin e shkollës.

Neni 126

- (1) Këshilli i shkollës fillore:
 - miraton statutin e shkollës fillore,
 - ia propozon programin vjetor për punë dhe raportin për punën e shkollës fillore këshillit të komunës,
 - e miraton programin për zhvillimin e shkollës,
 - miraton programin për zbatimin e standardeve më të larta dhe programe të tjera,
 - ia propozon planin financiar themeluesit,
 - ia propozon llogarinë përfundimtare themeluesit,

- publikon shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit të shkollës fillore, në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. [14](#)
- bën interviste me kandidatët për drejtor,
- ia propozon kryetarit të komunës një, përkatësisht dy kandidatë nga kandidatët e paraqitur në shpalljen publike të publikuar për zgjedhjen e drejtorit,
- i jep mendim drejtorit për zgjedhjen e arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve,
- i parashtron propozim drejtorit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së personave nga neni 96 paragrafi (1) të këtij ligji,
- vendos ndaj kundërshtimeve dhe ankesave të të punësuarve në shkollën fillore,
- vendos ndaj ankesave të nxënësve, prindërve, përkatësisht kujdestarëve të nxënësve dhe
- kryen punë të tjera, të përcaktuara me statutin e shkollës fillore.

(2) Këshilli i shkollës fillore për ankesat e parashtruara doemos duhet të vendose në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës.

Neni 127

(1) Nëse Inspektorati Shtetëror i Arsimit vlerëson se në shkollë në mënyrë të qenësore është çrregulluar procesi edukativ-arsimor, bën evalvim integral të jashtëzakonshëm dhe e obligon shkollën që shkaqet e çrregullimit t'i mënjanojë në afat prej një viti prej ditës së pranimit të raportit për evalvimin integral të bërë.

(2) Në qoftë se shkaqet për çrregullimin e procesit edukativ-arsimor shkolla nuk i mënjanon në afat prej një viti prej ditës së pranimit të raportit nga paragrafi (1) i këtij neni, në shkollë bëhet kontrollimi dhe vlerësimi i jashtëm i përparimit dhe të arritjeve të nxënësve.

(3) Nëse pas kontrollimit dhe vlerësimit të bërë të jashtëm nga paragrafi (2) i këtij neni konstatohet se dituria e nxënësve është nën standardet arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, themeluesit të shkollës fillore i propozon shkarkimin e të gjithë anëtarëve të këshillit të shkollës dhe të drejtorit të shkollës.

(4) Themeluesi në rastet e përcaktuara në paragrafin (3) të këtij neni është i obliguar që të veprjë në afat prej 15 ditësh prej ditës së pranimit të propozimit dhe menjëherë ta fillojë procedurën për emërimin e këshillit të ri të shkollës dhe ushtruesit të detyrës drejtor i shkollës.

(5) Në qoftë se themeluesi nuk vepron në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, Ministria sipas të drejtës së mbikëqyrjes, e për sigurimin e kryerjes së veprimtarisë i shkarkon anëtarët e këshillit të shkollës dhe menjëherë emëron këshill të ri të shkollës dhe ushtrues të detyrës drejtor me mandat më së shumti deri në një vit.

(6) Kërkesë për evalvim integral të jashtëzakonshëm dhe për kontrollim dhe vlerësim të jashtëm të përparimit dhe të arritjeve të nxënësve Inspektoratit Shtetëror të Arsimit mund t'i parashtrojnë Këshilli i komunës, kryetari ose këshilli i prindërve.

(7) Shpenzimet për kontrollimin dhe vlerësimin e jashtëm të përparimit dhe të arritjeve të nxënësve janë në barrë të kërkuarit.

2. ORGANI I UDHËHEQJES SË SHKOLLËS FILLORE

Neni 128

(1) Organ i udhëheqjes së shkollës fillore është drejtori.

(2) Drejtori është përgjegjës për ligjshmërinë në punë dhe për punën materiale-financiare të shkollës.

(3) Për drejtor të shkollës fillore mund të zgjidhet personi i cili ka së paku arsim të lartë dhe që i plotëson kushtet për arsimtar ose bashkëpunëtor profesional në shkollën fillore dhe nëse ka së paku pesë vjet përvojë punë në punën edukative-arsimore, provimin e dhënë për drejtor, në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion kundërvajtës ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës, të ketë certifikatë përkatëse, jo më të vjetër se pesë vjet, për njohjen e gjuhës angleze TOEFEL IBT (TOEFEL IBT) - së paku 30 pikë, IELTS (IELTS) - së paku 3 pikë, BULATS (BULATS) - së paku 20 pikë apo KET (KET) (Cambridge English) - të dhënë, APTIS (APTIS) - së paku niveli 2 (A2) dhe të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet. [15](#)

(4) Me përjashtim, nëse nuk janë paraqitur kandidatë me provimin e dhënë për drejtor, për drejtor mund të zgjidhet edhe personi i cili nuk e ka të dhënë provimin për drejtor, por është i detyruar që të njëjtin ta japë në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes për drejtor.

(5) Nëse drejtori i zgjedhur nuk e jep provimin për drejtor në afatin e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, i ndërpritet mandati i drejtorit.

(6) Mandati i njëpasnjëshëm në shkollën e njëjtë drejtorit zgjat 4 vjet, me mundësi edhe për një mandat. [16](#)

(7) Mësimdhënësit apo bashkëpunëtorit profesional që është zgjedhur drejtor i shkollës fillore i pezullohet marrëdhënia e punës gjatë kohës së kryerjes së funksionit drejtor i shkollës fillore dhe ka të drejtë në afat prej 15 ditësh pas pushimit të funksionit që e ka kryer, të kthehet në punë në shkollën ku ka punuar para se të zgjidhet drejtor për kryerje të punëve që i përgjigjen llojit dhe shkallës së tij të përgatitjes profesionale.

Neni 129

(1) Aftësimin e kandidatëve për drejtorë të shkollave fillore, dhe dhënien e provimit pas mbarimit të trajnimit të suksesshëm e bën Qendra për provim shtetëror, në pajtim me ligjin.

(2) Programin për përgatitjen dhe dhënien e provimit për drejtorë dhe mënyrën e zbatimit të provimit e përcakton ministri me propozimin e Qendrës për provim shtetëror.

(3) Kandidatit i cili e ka dhënë provimin për drejtor i jepet certifikatë.

(4) Formën dhe përmbajtjen e certifikatave për dhënien e provimit për drejtor të shkollës fillore e përcakton ministri.

Neni 130

Drejtori i kryen punët në vijim:

- e përfaqëson dhe e prezanton shkollën dhe është përgjegjës për punën e ligjshme,
- e organizon, e planifikon dhe e udhëheq punën e shkollës fillore,
- e përgatit programin për zhvillimin e shkollës,
- e përgatit propozimprogramin vjetor për punë,
- është përgjegjës për realizimin e programit vjetor për punë,
- është përgjegjës për realizimin e të drejtave dhe të obligimeve të nxënësve,
- e bën zgjedhjen e arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve profesionalë dhe të kuadrit tjetër administrativ- teknik në përputhje me ligjin dhe me aktet e shkollës,
- e bën sistematizimin e arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve profesionalë dhe të kuadrit tjetër administrativ-teknik,
- vendos për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve profesionale dhe të kuadrit tjetër administrativ-teknik në përputhje me ligjin dhe me marrëveshjen kolektive,
- e formon dhe udhëheq me Komisionin e Shkollës për kontrollimin ekstern të arritjeve të nxënësve dhe
- kryen kontroll mbi mënyrën e mbajtjes së dosjeve profesionale nga neni 91 paragrafi (3) të këtij ligji.
- e nxit aftësimin profesional dhe aftësimin e arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve profesionalë,
- organizon mentorim për arsimtarët - praktikantë, për bashkëpunëtorët profesionalë-praktikantë, për edukatorët-praktikantë, merr pjesë në orët e mësimin në pajtim me planin për dëgjim të orëve nga programi vjetor për punë të shkollës, për çfarë përpilon rekomandime dhe vërejtje nga dëgjimi i realizuar, të cilat i bashkëngjiten dosjes profesionale të mësimdhënësit dhe e përcjell punën e arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve profesionalë dhe i këshillon,
- e përcjell punën e pedagogut shkollor, të psikologut dhe të punëtorëve të tjerë profesionalë;
- kujdeset për bashkëpunimin me prindërit,
- i njofton prindërit për punën e shkollës dhe për ndryshimet e të drejtave dhe të obligimeve të nxënësve,
- merr vendim për masat edukative,
- e nxit dhe e përcjell punën e bashkësisë së nxënësve,
- e siguron zbatimin e vendimeve të këshillit të shkollës,
- e miraton sistematizimin e vendeve të punës së shkollës,
- vendos për lidhjen e marrëveshjeve për marrëdhëniet e punës,
- ngre procedurë për përgjegjësinë disiplinore të arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe edukatorëve profesionalë,
- kujdeset për bashkëpunimin e shkollës me institucionin shëndetësor në komunën dhe
- kryen punë të tjera në përputhje me ligjin dhe me statutin e shkollës.

Neni 131

(1) Në shkollën fillore mund të emërohet ndihmësdrejtor për kryerjen e punëve udhëheqëse dhe pedagogjike.

(2) Ndhimësdrejtor mund të emërohet personi i cili i përmbush kushtet për arsimtar, gjegjësisht bashkëpunëtor profesional i shkollës fillore dhe ka tre vjet përvojë pune në sferën e arsimit dhe është nga radhët e të punësuarve në shkollë.

(3) Ndhimësdrejtorin e emëron dhe e shkarkon drejtori me propozimin e këshillit të shkollës.

(4) Ndhimësdrejtori i kryen punët për të cilat e ka autorizuar me shkrim drejtori dhe e zëvendëson në mungesë të tij.

(5) Nëse në shkollë nuk ka ndihmësdrejtor, drejtori për kryerjen e detyrave të caktuara nga kompetenca e tij dhe për zëvendësim gjatë mungesës së tij, mund të autorizojë arsimtar ose bashkëpunëtor profesional nga shkolla fillore, i cili do ta zëvendësojë.

Neni 132

(1) Drejtorin e shkollës fillore komunale e zgjedh dhe e shkarkon kryetari i komunës, me propozimin e këshillit shkollor të shkollës fillore.

(2) Drejtorin e shkollës fillore shtetërore e zgjedh dhe e shkarkon ministri me propozimin e këshillit të shkollës të shkollës fillore.

(3) Kryetari i komunës, gjegjësisht ministri tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit ekzistues, merr vendim që këshilli i shkollës të shpallë konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit.

(4) Nëse kryetari i komunës, gjegjësisht ministri nuk vepron në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, këshilli i shkollës shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit.

(5) Në konkursin publik në mjetet publike të informimit përcaktohen kushtet që duhet t'i përmbushë kandidati për drejtor, dokumentacioni i nevojshëm, kohëzgjatja e konkursit publik dhe afati në të cilin do të bëhet zgjedhja.

(6) Kandidatet e paraqitur ia dërgojnë dokumentet e nevojshme këshillit të shkollës. Kandidatët, me fletëparaqitjen doemos ta bashkëngjisin edhe programin për punë për periudhën katërvjeçare.

(7) Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni i përbërë prej tre anëtarësh, i zgjedhur prej këshillit të shkollës kompetenca e të cilit përcaktohet me statutin e shkollës.

(8) Komisioni nga paragrafi (7) i këtij neni është i obliguar që në afat prej pesë ditësh pas mbarimit të konkursit publik t'i shqyrtojë dokumentet e arritura.

(9) Kandidatëve të cilët nuk i përmbushin kushtet e parapara në konkursin publik, u kthehen dokumentet me arsyetim në afat prej tre ditësh nga dita e shqyrtimit të të njëjtave.

(10) Këshilli i shkollës mund të kërkojë dokumente plotësuese nga kandidatët të cilët i përmbushin kushtet në përputhje me dispozitat në statutin e shkollës.

(11) Këshilli i shkollës dhe përfaqësuesi i Byrosë bëjnë intervistë me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet.

(12) Këshilli i shkollës fillorë të komunës, në afat prej shtatë ditësh nga biseda e bërë me kandidatët, kryetarit të komunës i propozon dy kandidatë për zgjedhjen e drejtorit, nëse në konkursin publik janë paraqitur më shumë kandidatë.

(13) Këshilli i shkollës fillorë shtetërorë në afat prej shtatë ditësh nga biseda e bërë me kandidatët, ministrit i propozon dy kandidatë për zgjedhjen e drejtorit, nëse në konkursin publik janë paraqitur më shumë kandidatë.

(14) Kryetari i komunës, gjegjësisht ministri, në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të propozimit zgjedh një kandidat për drejtor të shkollës fillore.

(15) Nëse kryetari i komunës, në afatin e përcaktuar në paragrafin (14) të këtij neni nuk e zgjedh drejtorin, zgjedhjen e bën ministri.

(16) Kandidatet të cilët nuk janë zgjedhur, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit, kanë të drejtë ankesë që ka të bëjë me zbatimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(17) Kundër vendimit të komisionit nga paragrafi (16) i këtij neni, kandidati mund të ngrejë kontest administrativ para gjyqit kompetent.

Neni 133

(1) Drejtorit të shkollës fillore mandati i pushon, nëse:

- vetë e kërkon atë,
- në mënyrë të përhershme e humb aftësinë për kryerjen e detyrës së drejtorit dhe
- i përmbush kushtet për pensionin e pleqërisë.

(2) Drejtori i shkollës fillore shkarkohet para skadimit të mandatit, nëse:

- bën cenimin e dispozitave të ligjeve ose të dispozitave dhe akteve të tjera, të përcaktuara nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit,
- nuk e realizon programin për punë dhe nuk realizohen planet dhe programet për punën edukative-arsimore,
- me fajin e tij u është shkaktuar dëm nxënësve, prindërve të tyre ose shkollës,
- e lejon organizimin e veprimtarive dhe të aktiviteteve të cilat janë në kundërshtim me planin dhe me programet mësimore,

- tri vite gjatë mandatit të tij, së paku 10% të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të punësuar në shkollë, gjenden në grupin e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, të cilët tregojnë rezultate më të dobëta nga kontrollimi ekstern, të përmbajtura në Raportin vjetor për punën arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;
- e lejon pagimin e mjeteve të cilat nuk janë përcaktuar në planin vjetor financiar të shkollës.

(3) Drejtori i shkollës fillore shkarkohet në afat prej 15 ditësh nga kryetari i komunës para skadimit të mandatit, nëse nuk vepron në pajtim me nenin 97 paragrafët (14) dhe (15) të këtij ligji.

(4) Drejtori shkarkohet nga ministri në afat prej 15 ditëve pas skadimit të afatit nga paragrafi (3) i këtij neni, nëse kryetari i komunës nuk vepron në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

Neni 134

(1) Nëse ekzistojnë njohuri të caktuara për veprimin e drejtorit në përputhje me dispozitat e nenit 133, paragrafi (2) i këtij ligji, këshilli i shkollës thërret seancë në të cilën miraton konkluzion në formë të shkruar, i cili i dërgohet drejtorit.

(2) Drejtori ka të drejtë që në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit nga paragrafi (1) i këtij neni, të prononcohet me shkrim për të argumentet në konkluzion.

(3) Nëse këshilli i shkollës nuk e pranon shpjegimin e drejtorit, thërret seancë në afat prej tri ditësh dhe në praninë e përfaqësuesit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit bën intervistë me drejtorin. Përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit jep mendim për arsyen e shkarkimit të drejtorit.

(4) Nëse këshilli i shkollës vlerëson se është e domosdoshme, në afat prej shtatë ditësh i dërgon propozim për shkarkimin e drejtorit të shkollës fillore të komunës kryetarit të komunës, gjegjësisht drejtorit të shkollës fillore shtetërore, ministrit.

(5) Kryetari i komunës gjegjësisht ministri, është i obliguar që në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të propozimit nga këshilli i shkollës ta shkarkojë drejtorin.

(6) Drejtori i shkarkuar, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të kryetarit të komunës, gjegjësisht të ministrit, ka të drejtë ankesë që ka të bëjë me zbatimin e procedurës për shkarkimin, Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(7) Kundër vendimit të Komisionit nga paragrafi (6) i këtij neni kandidati mund të ngrejë kontest administrativ para gjyqit kompetent.

Neni 135

- (1) Kryetari i komunës, gjegjësisht ministri në afat prej tri ditësh nga dita e shkarkimit të drejtorit, emëron ushtrues të detyrës drejtor nga radhët e të punësuarve në shkollë, i cili i përmbush kushtet për drejtor.
- (2) Kryetari i komunës, gjegjësisht ministri, në afat prej pesë ditësh nga dita e emërimit të ushtruesit të detyrës së drejtorit, merr vendim që këshilli i shkollës të shpallë konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit.
- (3) Ushtruesi i detyrës drejtor, emërohet edhe në rastet e pushimit të parakohshëm të mandatit të drejtorit.
- (4) Ushtruesi i detyrës drejtor i kryen punët deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më shumë se gjashtë muaj prej ditës së emërimit të tij.
- (5) Personi i njëjtë një pas një nuk mund të emërohet ushtrues i detyrës drejtor i shkollës fillore.

Neni 136

- (1) Inspektorati Shtetëror i Arsimit, pas konstatimit të cenimeve më të rënda në punë, në përputhje me nenin 133 paragrafi (2) i këtij ligji, drejtorit të shkollës fillore i dërgon raport me propozimmasa, sipas të cilave drejtori duhet të veprojë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të raportit.
- (2) Nëse drejtori i shkollës nuk vepron në aftin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, Inspektori Shtetëror i Arsimit, Këshillit të shkollës i dërgon aktvendim për zbatimin e propozimmasave. Afati për zbatimin e aktvendimit është 30 ditë nga dita e pranimin të tij.
- (3) Nëse Këshilli i shkollës nuk vepron sipas aktvendimit për zbatimin e propozimmasave, Inspektorati Shtetëror i Arsimit ia dërgon aktvendimin kryetarit të komunës dhe themeluesit të shkollës fillore, ndërsa për shkollën fillore shtetërore, ministrit dhe themeluesit të shkollës fillore.
- (4) Kryetari i komunës, gjegjësisht ministri në afat prej 30 ditësh prej ditësh së pranimin të aktvendimit për zbatimin e propozimmasave, është i obliguar që ta shkarkojë drejtorin e shkollës, ndërsa themeluesi, këshillin e shkollës.
- (5) Nëse kryetari i komunës nuk e shkarkon drejtorin, ndërsa themeluesi këshillin e shkollës në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, Ministria sipas së drejtës për mbikëqyrje, i shkarkon drejtorin dhe anëtarët e këshillit të shkollës fillore.
- (6) Ministria menjëherë sipas të drejtës për mbikëqyrje, e emëron ushtruesin e detyrës drejtor nga radhët e të punësuarve në shkollë, i cili i kryen punët më së shumti gjashtë muaj dhe emëron anëtarë të këshillit të shkollës me mandat prej më së shumti një vit.

Neni 137

I fshirë [17](#)

Neni 138

Shkollën fillore rajonale e udhëheq udhëheqësi i shkollës rajonale të cilin e emëron dhe e shkarkon drejtori nga radhët e mësimdhënësve të shkollës fillore rajonale.

3. ORGANET PROFESIONALE TË SHKOLLËS FILLORE

Neni 139

Organet profesionale të shkollës fillore janë këshilli i arsimtarëve të shkollës fillore, këshilli i mësuesve të grupit klasor, këshilli i arsimtarëve lëndorë, udhëheqësi i klasës, udhëheqësi i paraleles dhe aktivat profesionale të shkollës.

Neni 140

(1) Këshillin e arsimtarëve të shkollës fillore e përbëjnë mësuesit e grupit klasor dhe arsimtarët lëndorë dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës. Këshillin e arsimtarëve e thërret dhe me të kryeson drejtori.

(2) Këshilli i arsimtarëve i shkollës fillore:

- jep mendime për propozimprogramin për zhvillim dhe për programin vjetor të punës dhe e përcjell realizimin e tij,
- e shqyrton dhe e verifikon suksesin e nxënësve dhe punën e organeve të tjera profesionale,
- u lejon nxënësve përparim më të shpejtë në shkollën fillore,
- e shqyrton realizimin e planit mësimor dhe të programeve dhe ndërmerri masa për zbatimin e tyre,
- merr vendime për kundërshtimet e nxënësve për notat e caktuara,
- e shqyrton raportin e realizimit të programit vjetor të punës, nga vetëvlerësimi, nga kryerja e vlerësimit integral dhe propozon masa përkatëse,
- shqyrton dhe vendos për çështjet profesionale që kanë të bëjnë me punën edukative-arsimore;
- jep mendim për planin vjetor financiar të shkollës,
- zgjedh përfaqësues në këshillin e shkollës,
- jep mendime për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e arritjeve në mësim dhe në nxënie,
- e miraton orarin intern për kontrollimin ekstern të arritjeve të suksesit të nxënësve,
- e shqyrton Raportin vjetor për punën e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë dhe Raportin nacional për punën e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë dhe propozon masa adekuate,
- jep propozime për përparimin e arsimtarëve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë të shkollës,
- merr vendim për masat edukative dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me statutin e shkollës.

Neni 141

(1) Këshillin e mësuesve të grupit klasor e përbejnë mësuesit e grupit klasor, arsimtarët lëndorë të cilët inkuadrohen në realizimin e mësimit prej klasës së parë deri të pestën dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës.

(2) Këshilli i mësuesve të grupit klasor, e shqyrton programin vjetor të punës dhe të planifikimit të mësimit, problemet edukative-arsimore nëpër klasa, përgatit program për punë me nxënësit e talentuar, gjegjësisht për nxënësit të cilët përparojnë me vështirë, propozon dhe merr vendim për masat edukative dhe kryen punë të tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

Neni 142

(1) Këshillin e arsimtarëve të lëndës e përbejnë arsimtarët lëndorë, të cilët e realizojnë mësimin prej klasës së gjashtë deri të nëntën dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës.

(2) Këshilli i arsimtarëve të lëndës i shqyrton programin vjetor të punës dhe të planifikimit të mësimit, problemet edukative-arsimore nëpër klasa, përgatit program për punë me nxënësit e talentuar, gjegjësisht për nxënësit të cilët përparojnë me vështirë, merr vendim për masat edukative dhe kryen punë të tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

Neni 143

Udhëheqësi i klasës gjegjësisht udhëheqësi i paraleles e realizon programin për orën e bashkësisë së klasës, i analizon rezultatet edukative dhe mësimore të klasës, kujdeset për zgjidhjen e problemeve edukative dhe arsimore të nxënësve të caktuar, bashkëpunon me prindërit dhe me bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës, propozon dhe merr vendim për masat edukative dhe kryen punë të tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

Neni 144

(1) Aktivat profesionale të arsimtarëve i përbëjnë arsimtarë të cilët e ligjërojnë lëndën ose fushën e njëjtë.

(2) Aktivat profesionale të shkollës i harmonizojnë kriteret për planifikimin e mësimit dhe për vlerësimin e të arriturave të nxënësve, u japin propozime këshillave arsimore të shkollës për përmirësimin e punës edukative-arsimore, marrin vendim për përdorimin e teksteve shkollore në shkollën fillore, shqyrtojnë vërejtjet e prindërve, të nxënësve dhe kryejnë punë të tjera profesionale të përcaktuara me programin vjetor për punën e shkollës.

4. KËSHILLI I PRINDËRVE

Neni 145

(1) Për realizimin e organizuar të interesave të nxënësve në shkollën fillore prej prindërve të nxënësve formohet këshilli i prindërve të shkollës.

(2) Në këshillin e prindërve ka nga një përfaqësues nga çdo paralele, të cilin e zgjedhin prindërit në mbledhjen prindërore të paraleles.

(3) Konvokimin e parë të këshillit të prindërve e bën drejtori i shkollës.

(4) Këshilli i prindërve:

- jep mendim për propozimprogramin për zhvillimin e shkollës fillore dhe për programin vjetor për punë,
- shqyrton raportin për punën e shkollës,
- propozon programe për përmirësimin e standardeve për mësimin,
- jep pëlqim për propozimet e drejtorit për vendosjen e standardëve me të lartë,
- shqyrton ankesa të prindërve lidhur me punën edukative-arsimore,
- zgjedh përfaqësues në këshillin e shkollës fillore dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me statutin e shkollës.

XI. SIGURIMI I CILËSISË NË MËSIM

Neni 146

Për sigurimin e cilësisë së mësimin, Këshilli i Shkollës në çdo katër vite miraton program për zhvillimin e shkollës, në të cilin merren parasysh rezultatet e vetevaluimit të realizuar nga ana e Komisionit të Shkollës, ndihma këshillëdhënëse dhe profesionale nga Byroja, rekomandimet nga raporti prej evaluimit integral të realizuar nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, si dhe rezultatet nga evaluimi ekstern, të përmbajtura në Raportin vjetor për punën e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë nga ana e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 147

(1) Në çdo dy vite për realizimin e programeve nga neni 146 të këtij ligji, shkolla kryen vetevaluim.

(2) Vetevaluimi nga paragrafi (1) i këtij neni, realizohet në fund të çdo viti të dytë shkollor.

(3) Vetevaluimin e zbaton komisioni i shkollës i përbërë nga pesë anëtarë nga radhët e arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve profesionale, të edukatorëve dhe të prindërve, të cilin me propozimin e drejtorit e formon këshilli i shkollës.

(4) Vetevaluimi, veçanërisht i përfshin fushat në vijim:

- organizimin dhe realizimin e mësimin dhe të nxënies,
- arritjet e nxënësve,
- zhvillimin profesional të arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve profesionalë dhe të kuadrit udhëheqës,
- administrimin dhe udhëheqjen,
- komunikimet dhe marrëdhëniet me publikun,
- ambientin dhe kulturën shkollore dhe
- bashkëpunimin me prindërit dhe me mjedisin lokal.

(5) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni përgatit raport për vetevalvimin e bëre, me propozimmasa për përmirësimin e kualitetit të mësimit, të cilin ia dërgon këshillit të shkollës, drejtorit të shkollës dhe themeluesit. Këshilli i shkollës dhe drejtori duhet të veprojnë sipas propozimmasave të komisionit.

Neni 148

(1) Rezultatet nga vetevalvimi i shkollave fillore, publikohen në ueb faqen e shkollës dhe të komunës.

(2) Raportin me rezultatet nga vetevaluimi, shkolla e dërgon në Qendrën Shtetërore të Provimeve.

Neni 149

Mënyrën dhe fushat për kryerjen e vetevalvimit të shkollave fillore i përcakton ministri.

XII. NOSTRIFIKIMI DHE EKVIVALENCA E DËFTESAVE TË MARRA JASHTË VENDIT

Neni 150

(1) Shtetasi i Republikës së Maqedonisë, i cili e ka kryer shkollën fillore e ka kryer jashtë vendit ose ka kryer klasë të caktuar të edukimit dhe arsimit fillor, ka të drejtë të kërkojë njohjen e dëftesës, gjegjësisht nostrifikim ose njohjen e ekuivalencës në përputhje me këtë ligj, në qoftë së me marrëveshjet ndërkombëtarë nuk është caktuar ndryshe.

(2) Shtetasi i huaj dhe personi pa shtetësi ka të drejtë të kërkojë nostrifikimin ose njohjen e ekuivalencës së dëftesës së pranuar jashtë vendit.

Neni 151

(1) Me nostrifikimin bëhet njohja e dëftesës së pranuar jashtë vendit në tërësi në aspekt të të drejtave që i takojnë poseduesit të dëftesës për vazhdimin e arsimit.

(2) Me ekuivalencën bëhet barazimi i dëftesës së pranuar jashtë vendit me dëftesën përkatëse të marrë në Republikën e Maqedonisë.

(3) Nostrifikimin, gjegjësisht njohjen e ekuivalencës së dëftesës së pranuar jashtë vendit e bën Ministria.

Neni 152

Me nostrifikimin dhe me njohjen e ekuivalencës dëftesa e marrë jashtë vendit barazohet me dëftesën përkatëse të marrë në Republikën e Maqedonisë në tërësi në aspekt të të drejtave që i takojnë poseduesit për vazhdimin e arsimit.

Neni 153

Në procedurën për nostrifikimin dhe njohjen e ekuivalencës së dëftesës së marrë jashtë vendit, gjegjësisht ekuivalenca e tyre, merret parasysh:

- sistemi i arsimit në shtetin ku është lëshuar dëftesa,
- kohëzgjatja e arsimit,
- plani arsimor dhe programet,
- të drejtat që dëftesa ia jep poseduesit në vendin ku është lëshuar dhe
- punë të tjera me rëndësi për nostrifikimin dhe ekuivalencën.

Neni 154

Nëse në procedurën për nostrifikimin gjegjësisht për ekuivalencën konstatohet se plani arsimor dhe programet në mënyrë qenësore nuk janë në përputhje me plani mësimor dhe programet në Republikën e Maqedonisë, me të cilat krahasohet, nostrifikimi kushtëzohet me hyrjen në provim lëndor.

Neni 155

(1) Me kërkesën për nostrifikimin dhe njohjen e ekuivalencës së dëftesës së lëshuar jashtë vendit, dërgohet origjinali i dëftesës së lëshuar nga shkolla fillore e huaj e verifikuar, një ekzemplar i përkthimit të bërë nga përkthyesi i autorizuar dhe i verifikuar te noteri dhe dy ekzemplarë të së njëjtës. Kërkuesi duhet të dërgojë edhe plan mësimor dhe programe sipas të cilave nxënësi është arsimuar jashtë vendit.

(2) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni dërgohet edhe dëshmi për arsimin e kryer paraprakisht dhe dëshmi për shtetësinë.

(3) Ministria mund të kërkojë edhe dëshmi të tjera me përkthim të verifikuar, prej të cilave mund të shihen kushtet dhe rrjedha e arsimit.

(4) Nëse kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e përmban dokumentacionin e tërësishëm, komisioni në afat prej 10 ditësh nga pranimi i kërkesës, e lajmëron me shkrim personin që ta dërgojë dokumentacionin i cili mungon.

Neni 156

(1) Personi i cili ka parashtruar kërkesë për nostrifikim, gjegjësisht për njohjen e ekuivalencës së dëftesës së lëshuar jashtë vendit, me kusht mund ta vijojë klasën në vijim, në qoftë se procedura nuk ka përfunduar deri në skadimin e afatit për regjistrimin e nxënësve në shkollë.

(2) Nxënësi, dëftesa e të cilit në bazë të nostrifikimit të bërë, gjegjësisht të njohjes së ekuivalencës jep të drejtë për regjistrim në klasë më të ulët të vitit në të cilin është regjistruar me kusht, transferohet në vitin përkatës dhe me këtë anulohet regjistrimi me kusht.

Neni 157

(1) Aktvendimin për nostrifikimin dhe aktvendimin për njohjen e ekuivalencës së dëftesës së lëshuar jashtë vendit e miraton ministri me propozimin e komisionit.

(2) Komisionin nga paragrafi (1) i këtij neni e formon ministri dhe përbehet nga persona profesionalë të dalluar, me arsim sipëror dhe më së paku shtatë vjet përvojë pune në veprimtarinë edukative-arsimore ose në organin e administratës shtetërore kompetent për punët në arsimin.

(3) Më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni janë nga veprimtaria edukative-arsimore.

(4) Kundër aktvendimit për refuzimin e nostrifikimit gjegjësisht të ekuivalencës mund t'i paraqitet ankesë Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë nga sfera e arsimit.

Neni 158

(1) Ministri në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për nostrifikim, përkatësisht ekuivalencë, miraton aktvendim me të cilin vendosë për kërkesën për nostrifikimin, përkatësisht ekuivalencën e dëftesës së marrë jashtë shtetit (në tekstin e mëtejme: aktvendimi për nostrifikim, përkatësisht ekuivalencë).

(2) Nëse ministri nuk miraton aktvendim për nostrifikim, përkatësisht ekuivalencë, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës të paraqesë kërkesë në sekretarinë e ministrit dhe ministri të miratojë aktvendim.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, i përcakton ministri.

(4) Me kërkesën për miratimin e aktvendimit për nostrifikim, përkatësisht ekuivalence, kërkuesi dorëzon edhe kopje të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Ministri është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e paraqitjes së kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni në sekretarinë e ministrit, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për nostrifikim, përkatësisht ekuivalence pranohet apo refuzuar. Nëse ministri nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Ministrisë.

(6) Nëse ministri nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(7) Inspektori është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (6) i këtij neni, të kryeje mbikëqyrje në Ministrinë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(8) Inspektori pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësisht ta miratojë apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur.

(9) Nëse Ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse Ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (9) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(11) Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh ka të drejtë të parashtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(12) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (11) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni dhe/ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin kompetent nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (12) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, do të paraqesë kallëzim të prokurori publik kompetent kundër inspektorit, dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës. [18](#)

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(15) Në rastet nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (12) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtojë kallëzim të prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(17) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(18) Akti nënligjor nga paragrafi (3) i këtij neni, miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

(19) Pas miratimit të aktit nënligjor, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrisë.

Neni 159

(1) Kompensimi i shpenzimeve në procedurën e nostrifikimit përcaktohet në bazë të shpenzimeve të bëra reale.

(2) Lartësinë e kompensimit të shpenzimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe mënyrën e shpërndarjes së kompensimit, i përcakton ministri.

Neni 160

Ministria e ruan dokumentacionin e nostrifikimit të kryer, përkatësisht ekuivalencës dhe për këtë mban evidencë.

Neni 161

Formën dhe përmbajtjen e formularëve për nostrifikim përkatësisht ekuivalencë, dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës i përcakton ministri.

VIII. FINANCIMI I ARSIMIT FILLOR

Neni 162

(1) Mjetet për financimin e veprimtarisë në arsimin fillor sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Ligjin për Buxhetet e Republikës së Maqedonisë, Ligjin për zbatimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe me Ligjin për financimin e njësive të vetadministrimit lokal.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni, komunave u shpërndahen përmes bllok-dotacioneve dhe dotacioneve me dedikim në përputhje me Urdhëresën për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për shpërndarjen e bllok-dotacioneve dhe me Urdhëresën e metodologjisë për shpërndarjen e dotacioneve kapitale dhe dotacioneve me dedikim të përcaktuara në Ligjin për financimin e njësive të vetadministrimit lokal.

(3) Komuna mjete nga paragrafi (2) i këtij neni ua shpërndan shkollave fillore të rajonit të vet për sigurimin e realizimit të procesit edukativ-arsimor, në përputhje me standardet dhe normat e përcaktuara.

(4) Me Urdhëresat nga paragrafi (2) i këtij neni, rregullohet shpërndarja e mjeteve nga bllok dotacioni dhe nga dotacioni me dedikim e cila bëhet në bazë të formulës dhe në përputhje me fazat e decentralizimit fiskal të përcaktuara në Ligjin për financimin e njësive të vetadministrimit lokal.

(5) Formula nga paragrafi (4) i këtij neni, për shpërndarjen e mjeteve kryesisht realizohet në bazë të numrit të nxënësve në shkollat fillore të rajonit të vet. Mbi realizimin e formulës ndikim mund të kenë edhe treguesit e tjerë plotësues.

Neni 163

Komuna mund ta plotësojë bllok dotacionin e fituar, përkatësisht dotacionin me dedikim për arsim me mjete nga burimet vetjake, përveç për pagat e punonjësve të shkollave.

Neni 164

(1) Të dhënat nga plani financiar vjetor dhe nga llogaria përfundimtare e shkollave fillore, komuna i shpall në fletoren e vet zyrtare.

(2) Ministri e përcakton se cilat të dhëna do të publikohen.

Neni 165

Mjetet për financimin e veprimtarisë së arsimit fillor mund të sigurohen edhe prej burimeve të tjera (legata, dhurata, testamente e tjerë), ndërkaq shfrytëzohen me dedikim.

Neni 166

(1) Ministria për mjetet e financimit të arsimit fillor miraton plan dhe programe financiare dhe përlllogaritje vjetore.

(2) Ministria përcakton masa dhe kritere për shpërndarjen e mjeteve për shkollat fillore shtetërore.

(3) Këshilli komunal përcakton masa dhe kritere për shpërndarjen e mjeteve për shkollat fillore komunale.

(4) Ministria e kontrollon shfrytëzimin me dedikim të mjeteve që shpërndahen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 167

Shkollat fillore kanë për detyrë të kontraktojnë sigurim përkatës për përgjegjësi nga dëmi i shkaktuar, për të cilën gjë mjetet i siguron themeluesi.

XIV. MBIKËQYRJA

Neni 168

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji bën Ministria.

(2) Mbikëqyrje inspektimi mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji bën Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe inspektorët e autorizuar të komunave, në përputhje me ligjin.

Neni 168-a

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës konstaton se për herë të parë është bërë parregullsi nga neni 172 i këtij ligji, detyrohet që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose shkollës fillore, ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar komunal i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të njëllajta për një ose më shumë persona, përkatësisht për një apo më shumë shkolla fillore.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose shkolla fillore për të cilën realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi ose shkolla fillore për të cilën realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri.

Neni 169

(1) Kur Ministria do të konsiderojë se statuti ose ndonjë akt tjetër i shkollës fillore nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, ka të drejtë aktin ta ndërpresë nga zbatimi deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

(2) Nëse Ministria gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga neni 168 paragrafi (1) i këtij ligji, konstaton se shkolla fillore ka lëshuar dëftesa në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, miraton aktvendim për shfuqizimin e tyre i cili botohet në mjetet e informimit publik dhe paraqet kallëzim pranë organit për ndjekje penale.

Neni 170

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës, Ministria i kryen punët si vijojnë:

- e ndjek ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, ndërmerr masa dhe aktivitete dhe ngre iniciative për realizimin e kompetencave të komunës në përputhje me këtë ligj,
- vlerëson nëse organet e komunës kompetencat i kryejnë në përputhje me këtë ligj,
- u sugjeron organeve të komunës për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe me rregulla të tjera dhe ju propozon masa përkatëse për tejkalimin e situatës së atillë,
- u sugjeron për mangësi të caktuara materiale dhe procedurale në punën e organeve të komunës me të cilat pamundësohet kryerja e punëve nga fusha e arsimit fillor me peshë lokale,
- jep rekomandime për zbatim konsekuent të kompetencave të komunës në përputhje me këtë ligj, me kërkesë të organeve të komunës,
- e ndjek nxjerrjen me kohë të rregullave të komunës të parapara me këtë ligj,
- e ndjek ligjshmërinë e aktvendimeve që i miraton kryetari i komunës në zgjidhjen e të drejtave individuale, obligimeve dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë dhe ndërmerr masa në përputhje me këtë ligj,
- jep mendime dhe ndihmë profesionale në lidhje me projekt rregullat e komunës të parapara me këtë ligj, me kërkesë të organeve të komunës,
- e ndjek realizimin e transparencës në punën e organeve të komunës, në realizimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj, dhe veçanërisht nga aspekti i njoftimit të rregullt, me kohë, të drejtë dhe të plotë të qytetarëve,
- e ndjek realizimin e mbikëqyrjes paraprake mbi rregullat e komunës dhe
- me kohë i njofton organet e komunës për gjendjet e konstatuara gjatë punës së tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(2) Për masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga paragrafi (1) alinetë 6 dhe 7 të këtij neni, Ministria e informon organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e vetadministrimit lokal.

Neni 171

(1) Nëse krahas sugjerimeve dhe masave e aktiviteteve të ndërmarra, organet e komunës nuk e sigurojnë realizimin e punëve të cilat janë përcaktuar me ligj si kompetencë e saj dhe për realizimin e të cilave kompetente është komuna, me fuqinë e këtij ligji ju hiqet kryerja e kompetencës përkatëse.

(2) Kryerjen e punëve të hequra e ndërmerr Ministria, por më së shumti deri më një vit nga dita e marrjes së tyre.

(3) Ministria punët e hequra në kompetencë të komunës i kryen në emër dhe në llogari të komunës.

(4) Për heqjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, njoftohet organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e vetadministrimit lokal dhe organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e financave.

XV. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 172

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shollës fillore, nëse:

- emri i shkollës fillore është shkruar në kundërshtim me nenin 14 të këtij ligji,
- fut të dhëna të gabuara në bazën e integruar të të dhënave (neni 15-a),
- nuk paraqet orar për mësim plotësues dhe shtesë për çdo lëndë mësimore, në vend të dukshëm në shkollë dhe të njëjtin nuk e dorëzon në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit (neni 28-a),
- lëndët e obligueshme dhe zgjedhore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, realizohen në kundërshtim me nenin 30 paragrafi (2) të këtij ligji,
- nuk e organizon pranimin dhe mbrojtjen si dhe qëndrimin e vazhduar të nxënësve (neni 33 paragrafët (1) dhe (2)),
- nuk i njofton nxënësit dhe prindërit nëpërmjet broshurës me pjesët e veçanta nga programi për punë, të drejtat dhe obligimet e nxënësve dhe organizimin e punës në shkollë (neni 36),
- lëshon dokumente publike në kundërshtim me nenin 101 paragrafi (2) të këtij ligji dhe
- nuk lidh sigurim përkatës për përgjegjësi nga dëmi i shkaktuar (neni 167).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet drejtorit të shkollës fillore për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet mësimdhënësit për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje prindit, përkatësisht kujdestarit, nëse nxënësi nuk është regjistruar në afatin e përcaktuar në nenin 47 paragrafi (1) të këtij ligji.

(5) Gjobë në shumë prej 200 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prindit, përkatësisht tutorit për kundërvajtje nëse nuk paraqitet në terminin e caktuar për këshillim, pas ftesën së dytë të dërguar (neni 64-a paragrafi (2)).

(6) Gjobë në shumë prej 500 deri në 700 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prindit, përkatësisht tutorit për kundërvajtje nëse nuk paraqitet në terminin e caktuar për këshillim, pas ftesën së tretë të dërguar (neni 64-a paragrafi (2)).

(7) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prindit, përkatësisht kujdestarit, nëse nuk i mundëson fëmijës së tij që ta plotësojë obligimin për arsim dhe edukim të detyrueshëm fillor (neni 5).

Neni 172-a

(1) Gjobë në shumë prej 2.500 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shkollës fillore, nëse:

- në shkollën fillore bëhet diskriminim (neni 2 paragrafi (2)),
- puna edukativo - arsimore nuk realizohet në pajtim me nenin 9 të këtij ligji,
- nuk fut të dhëna në bazën e integruar të të dhënave (neni 15-a),
- organizohet shkollë rajonale pa vendimin e themeluesit dhe mendimit paraprak pozitiv nga ministri (neni 20 paragrafi (2)),
- nuk shfrytëzon teknologji informatike-komunikuese në mësim (neni 25 paragrafi (6)),
- programin vjetor për punë nuk e dorëzon te themeluesi, Byroja dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit në afatin e përcaktuar (neni 35 paragrafët (4) dhe (7)),
- nuk e realizon numrin e përgjithshëm të ditëve mësimore (neni 38 paragrafi (2)),
- organizohet paralele e kombinuar pa marrjen e pëlqimit nga themeluesi (neni 41 paragrafi (7)),
- organizon paralele me më pak se 24 nxënës pa marrjen e pëlqimit nga themeluesi (neni 45 paragrafi (5)),
- shkolla fillore në kohë nuk e organizon dhe kryen regjistrimin e nxënësve (neni 46 paragrafi (1)),
- nuk i përfshin nxënësit nga rajoni i vet (neni 46 paragrafi (2)),
- regjistron nxënës nga rajoni ose komuna tjetër pa pasur vende të lira (neni 46 paragrafi (3)),
- nuk e njofton inspektorin e autorizuar të arsimit të komunës për nxënësit të cilët nuk janë regjistruar, përkatësisht të cilët në mënyrë të paarsyeshme nuk shkojnë në shkollë më shumë se 30 ditë (neni 52),
- përsosja profesionale realizohet nëpërmjet programeve të paakredituara (neni 91 paragrafi (3)),
- nuk mbahet ose mbahet dhe lëshohet dokumentacioni pedagogjik në kundërshtim me nenet 99 dhe 100 të këtij ligji dhe
- vepron në kundërshtim me nenin 126 paragrafi (1) alinetë 2 dhe 3 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet drejtorit të shkollës fillore për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet mësimitdhënësit për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 1, 2, 5 dhe 15 të këtij neni, si dhe për kundërvajtje, nëse:

- nuk e realizon numrin vjetor dhe javor të orëve për mësimit në pajtim me planprogramin mësimit dhe (neni 25),
- si mësimitdhënësi klasor, përkatësisht udhëheqësi i paraleles nuk e njofton prindin për suksesin e nxënësit më së paku dy herë për çdo gjysmëvjetor (neni 67),
- si mësimitdhënësi klasor, përkatësisht udhëheqësi i paraleles notat vjetore nuk ua kumton prindërve në mbledhjen prindërore e cila mbahet tre ditë pas ditës së mbajtjes së këshillit të mësimitdhënëseve, në të cilën përcaktohen notat vjetore të nxënëseve (neni 72 paragrafi (1)),
- si mentor nuk përpilon program dhe raport nga neni 85 paragrafi (8) i këtij ligji,
- nuk e realizon mësimitin në mënyrë interaktive (neni 86 paragrafi (2)),
- nuk e planifikon mësimitin në formë të shkruar ose elektronike (neni 86 paragrafi (4) alineja 1) dhe
- kryen shitje të librave shkollorë, revistave dhe literaturës tjetër në shkollat fillore (neni 123 paragrafi (2)).

Neni 172-b

(1) Gjobë në shumë prej 3.500 deri në 4.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shkollës fillore, nëse:

- organizohet organizim dhe veprim politik dhe fetar dhe vendosen shenja partiake dhe fetare (neni 11),
- fillon punën para përcaktimit të plotësimit të kushteve për fillimin e punës dhe para miratimit të aktvendimit për verifikim (neni 19 paragrafi (2)),
- e ndërpret punën edukativo-arsimore në kundërshtim me nenin 38 paragrafi (6) të këtij ligji,
- kryhet maltretim fizik dhe psikik i nxënësit (neni 53),
- bën zgjedhjen e mësimitdhënëseve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë në kundërshtim me dispozitat e neneve 80, 82 dhe 84 të këtij ligji;
- vepron në kundërshtim me nenin 85 paragrafët (6), (7), (8) dhe (9) të këtij ligji;
- kryhet maltretim psikik apo fizik i mësimitdhënësit, bashkëpunëtorit profesional apo edukatorit (neni 86 paragrafi 5),
- mësimitdhënësit nuk i lëshon aktvendim të ri për orarin e punës (neni 95 paragrafi (2));
- pas evaluimit integral të kryer të jashtëzakonshëm, nuk i mënjanon shkaqet për prishjen e procesit edukativo-arsimor (neni 127 paragrafi (1)),
- nuk miraton program për zhvillimin e shkollës në pajtim me nenin 146 të këtij ligji,
- nuk realizon vetevaulim të shkollës (neni 147) dhe
- nuk e mundëson kryerjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë dhe mbikëqyrje inspektuese (neni 168).

(2) Gjobë në shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet drejtorit të shkollës fillore për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet mësimitdhënësit të shkollës fillore, për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 1, 3, 4 dhe 12 të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prindit, përkatësisht kujdestarit, nëse prindi, përkatësisht kujdestari ose fëmija i tij e keqtrajton psikikisht apo fizikisht mësimdhënësin, bashkëpunëtorin profesional apo edukatorin (neni 86 paragrafi 5).

(5) Shkollës fillore dhe drejtorit të shkollës fillore për veprimet nga paragrafi (1) alineja 2 e këtij neni, krahas gjobës së paraparë detyrimisht do t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalimi i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë me kohëzgjatje e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një, as më e gjatë se pesë vite, duke llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

Neni 172-v

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik, nëse lejon që testuesi dhe ndihmësi i testuesit të jenë nga radhët e mësimdhënësve të lëndës për të cilën kryhet kontrolli ekstern (neni 71 paragrafi (11)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet për kundërvajtje mësimdhënësve nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 71 paragrafi (8).

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet testuesit dhe ndihmësit të testuesit nëse jep çfarëdo qoftë informatash në lidhje me përgjigjet e pyetjeve (neni 71 paragrafi (10))."

(4) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje testuesit dhe ndihmësit të testuesit nëse janë nga radhët e mësimdhënësve të lëndëve për të cilat kryhet kontrolli ekstern (neni 71 paragrafi (11)).

Neni 173

Organ kompetent për kumtimin e sanksioneve për kundërvajtje është gjykata kompetente.

Neni 174

Para paraqitjes së kërkesës për procedurë për kundërvajtje, për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe inspektorët e autorizuar mbajnë procedurë për barazim në përputhje me Ligjin për barazim.

Neni 174-a

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë në procedurë mandatore inspektori shtetëror i arsimit do t'i shqiptojë për kundërvajtje personit juridik nëse nuk mbahet e-ditar në bazë javore në shkollën fillore (neni 100 paragrafi (4)).

(2) Gjobë në shumë prej 600 eurosh në kundërvlerë me denarë në procedurën mandatore inspektori shtetëror i arsimit do t'i shqiptojë për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik nëse nuk mbahet e-ditar në bazë javore në shkollën fillore (neni 100 paragrafi (4)).

(3) Gjohë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë në procedurën mandatore inspektori shtetëror i arsimit do t'i shqiptojë për kundërvajtje mësimdhënësit nëse nuk mban e-ditar në bazë javore në shkollën fillore (neni 100 paragrafi (4)).

(4) Gjohë në shumë prej 600 euro në kundërvlerë me denarë në procedurë mandatore inspektori shtetëror i arsimit do t'i shqiptojë për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik nëse nuk vepron në pajtim me nenin 97 paragrafët (14) dhe (15) të këtij ligji.

Neni 174-b

Mjetet nga gjobat e shqiptuara në procedurë mandatore nga inspektorët shtetërorë të arsimit janë të ardhura të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

XVI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 175

(1) Shkolla fillore në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e harmonizon organiken, punën, statutin dhe aktet e tjera të saj me këtë ligj.

(2) Deri në miratimin e akteve nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohen aktet ekzistuese të shkollës fillore nëse nuk janë në kundërshtim me këtë dhe ligj tjetër.

Neni 176

(1) Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, do t'i miratojë ministri në afat prej një viti nga dita e hyrjes së tij në fuqi, përveç akteve të parapara në nenin 129 të këtij ligji, të cilat ministri do t'i miratojë në afat prej tre muajsh pas themelimit të Qendrës shtetërore të provimeve, si dhe dispozitës nga neni 71 paragrafi (6) i këtij ligji të cilin ministri do ta nxjerrë deri më 31 dhjetor të vitit 2008.

(2) Deri në miratimin e akteve nga neni 129 të këtij ligji, do të zbatohet Rregullorja e procedurës dhe mënyrës së dhënies të provimit për drejtor të shkollës fillore, si dhe e formës dhe përmbajtjes së vërtetimit për provimin e dhënë për drejtor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 36/2005).

Neni 177

Deri në miratimin e akteve të parapara me këtë ligj do të zbatohen aktet ekzistuese.

Neni 178

Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojë në përputhje me Ligjin për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004/ 82/2004, 55/2005, 81/2005, 113/2005, 35/2006, 70/2006 dhe 51/2007).

Neni 179

(1) Nxënësit që janë regjistruar në shkollat fillore para vitit shkollor 2006/2007 e vazhdojnë shkollimin sipas planit dhe programeve arsimore për arsim fillor tetëvjeçar deri në kryerjen e arsimit të tyre fillor.

(2) Nxënësit të cilët në vitin shkollor 2006/2007 përcjellin vit përgatitor, në vitin shkollor 2008/2009 e vazhdojnë shkollimin në klasë të tretë sipas planit dhe programeve arsimore për arsim fillor nëntëvjeçar.

Neni 180

Nxënësit e regjistruar në shkollën fillore përfundimisht me vitin shkollor 2006/2007 do të vlerësohen me nota me numra prej klasës së katërt deri në të tetën të arsimit fillor tetëvjeçar, deri në kryerjen e arsimit fillor.

Neni 181

I shfuqizuar [19](#)

Neni 182

(1) Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, arsimtarët që mbajnë mësim në shkolla të veçanta fillore dhe paralele në shkollat fillore me përvojë pune mbi njëzet vjet në arsim vazhdojnë t'i kryejnë punët në vendet e punës në të cilat janë hasur.

(2) Arsimtarët të cilët nuk i përmbushin kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë për detyrë të kryejnë arsim përkatës më së voni për dy vjet nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 183

Dispozitat e nenit 8 të këtij ligji do të zbatohen prej vitit 2012.

Neni 184

Drejtoret e shkollave fillore të emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë t'i kryejnë funksionet e tyre deri në skadimin e kohës për të cilën janë emëruar.

Neni 185

(1) Nostrifikimi përkatësisht ekuivalenca e dëftesës e bëre në republikat dhe krahinat autonome të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, deri më 1 shtator të vitit 1991, ka vlerë të njëjtë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Dëftesat e personave të cilët arsimin e kanë kryer në ish republikat, përkatësisht shtetet e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë deri më 1 shtator të vitit 1995, ju njihen pa zbatimin e procedurës për nostrifikim.

Neni 186

Me ditë e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Enti për rehabilitimin e fëmijëve me dëgjim të dëmtuar “Koco Racin” - Manastir, Shkolla e veçantë fillore “Idnina” - Shkup, Institucioni publik për përkujdesjen e fëmijëve me probleme edukative- sociale - Shkup, Institucioni publik - Enti për rehabilitimin e fëmijëve dhe të rinjve - Shkup, Institucioni publik – Enti për përkujdesjen, edukimin dhe arsimin e fëmijëve dhe të rinjve “Ranka Milanoviq” - Shkup, Shkolla e veçantë për arsim fillor të fëmijëve me pengesa në zhvillimin psikik “D-r Zllatan Sremac” - Shkup, Institucioni publik – Ent për mbrojtje dhe rehabilitim “Banja Bansko” - Strumic, Shkolla e veçantë fillore për nxënës me nevoja të veçanta edukative-arsimore “Shën Klimenti i Ohrit” - Novo Sello dhe Shkolla e veçantë fillore me konvikt për nxënës “Maca Gjorgjieva Ovcarova“ - Veles, të cilave nuk u janë transferuar të drejtat themeluese të komunës, vazhdojnë me punë si shkolla fillore shtetërore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 187

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për arsimin fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004, 82/2004, 55/2005, 81/2005, 113/2005, 35/2006, 70/2006 dhe 51/2007).

Neni 188

(1) *I shfuqizuar* [20](#)

(2) Dispozitat e neneve 43 dhe 44 të këtij ligji, do të fillojë të zbatohet nga 1 shtatori i vitit 2012.

(3) Dispozita e nenit 85 paragrafi (7) të këtij ligji, do të fillojë të zbatohet me ditën e hyrjes në fuqi të aktit nga neni 85 paragrafi (13) të këtij ligji.

(4) Dispozitat e nenit 92 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 189

I fshirë [21](#)

Neni 190

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.